

Partneriteti Kundër Trafikimit në Qenie Njerëzore

Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Cilat janë njohuritë, vlerat, dhe perceptimet lidhur me trafikimin?

Kush janë klientët e punësorëve seksual?

Cili është niveli i vetëdijës mbi trafikimin dhe pasojat
e tij tek grupet e marginalizuara (vazrat e reja)?

Kush janë viktimat?

Kosovë, 2007

Partneriteti Kundër Trafikimit në Qenie Njerëzore

Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Kosovë 2007

Përmbjatja

1.	Hyrje	5
2.	Prapavija	5
3.	Objektivat	6
4.	Metodologjia	7
5.	Përmbledhje.....	7
6.	Të gjeturat – Sondazhi i popullsisë së përgjithshme	11
7.	Të gjeturat – Sondazhi me grupin më të cenueshëm (Vajza të moshës 14 deri 18 vjeçare).....	30
8.	Të gjeturat – Intervistat me viktime të trafikimit, të shpëtuar.....	52
9.	Gjetjet – Intervistat me klientët e punëtorëve të seksit komercial	62
10.	Shtojca – Metodologjia	75

Opinionet e paraqitura në këtë publikim nuk i përfaqësojnë qëndrimet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) e as të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USG).

► **ARTIKULLI MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË RESPUDENTIT**

Prism Research, në harmoni me normat dhe rregullat e ESOMAR dhe AAPOR është e obliguar të mbroj anonimitetin e respondentëve. Të gjitha pyetjet / ndryshoret të cilat përmbajnë çfarëdo informate mbi identitetin e respondentëve janë hequr nga ky raport dhe nga baza finale e të dhënave. Kjo do të thotë se të gjitha përgjigjet e dhëna nga respondentët janë fizikisht të ndara nga të dhënat lidhur me identitetin e tyre. Çfarëdo përpjekje e qëllimshme të arrihet deri tek të dhënat e respondentëve, qoftë nga Klienti, Prism Research, apo ndonjë subjekt tjetër do të konsiderohet si shkelje e rëndë e rregullave dhe do të trajtohet si e tillë.

1. Hyrje

Ky raport përmban të gjeturat nga hulumtimi i porositur nga Catholic Relief Service dhe Kosova Population Foundation nën projektin Partneritetin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PATH) që përkrahet nga USAID. Pjesa kuantitative e hulumtimit është e përbërë nga dy sondazhe, një me popullsinë e përgjithshme dhe tjetra me vajzat e reja të moshës 14 deri 18 vjeç, dhe është kryer në nëntor dhe dhjetor të vitit 2006. Rezultatet janë të mbështetura në intervista ballë-për-ballë me 500 shqiptar të Kosovës, serb të Kosovës, dhe minoritete tjera jo-serbe. Respondentët janë përzgjedhur me metodën e rastit në gjithë territorin e Kosovës dhe përfaqësojnë popullsinë e përgjithshme. Margjina e gabimit për këtë madhësi të mostrës është plus apo minus 5%. Sondazhi i vajzave të reja përfshin 300 intervista ballë-për-ballë të cilat po ashtu janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga të gjitha rajonet e Kosovës. Margjina e gabimit për këtë mostër është plus apo minus 5.5%. Pyetësi është zhvilluar në gjuhën angleze, pastaj është përkthyer dhe administruar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Hulumtimi kualitativ në formë të intervistave individuale është kryer me dhjetë viktima të mëparshme të trafikimit (të shpëtuar) dhe 18 klientë të punëtorëve të seksit. Mostra ka përfshirë shqiptar dhe serb të Kosovës sikurse edhe disa viktima të huaja të cilat tani banojnë në Kosovë. Kjo pjesë e hulumtimit është kryer në dhjetor të vitit 2006 dhe janar të vitit 2007.

Objektiva e këtij hulumtimi është të mësohet lidhur me njohurit, qëndrimet, dhe perceptimet e audiencës së ndryshme në shënjestër lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Kosovë. Rezultatet e këtij hulumtimi do të përdoren me qëllim të dizajnit dhe përmbajtjes së kampanjës mediale të organizuar në kuadër të projektit PATH. Ky hulumtimi po ashtu do të përmbush një nga aktivitetet e rëndësishme të cekura në Planin për Veprim të Luftimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore të Qeverisë së Kosovës dhe do të shërbej si pikë nisje prej nga do të matet efikasiteti i tentativës së përmirësimit të informimit të popullsisë.

Puna në terren është kryer nga Prism Research; instrumentet hulumtuese janë zhvilluar nga Prism në bashkëpunim me CRS, KOPF, Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, dhe të Grupit Punues Ndër-ministror për Çështje të Trafikimit. Do të dëshironim të çmujmë punën e kryer nga Selma Kapo dhe Vigan Behluli nga Prism Research për kontributin e tyre në këtë projekt dhe të strehimoreve të cilat kanë ndihmuar në këtë hulumtim. Ato do të mbesin të paemëruara për arsye të sigurisë.

Ky raport është i organizuar në Përmbledhje dhe katër seksione të fokusuara në audiencë të ndryshme në shënjestër.

2. Prapavija

Prism Research, agjenci profesionale për hulumtimin e opinionit publik, të tregut dhe të mediave, ka kryer këtë hulumtim të quajtur *Hulumtim Studimor për Trafikimin e Qenieve Njerëzore*. Është kryer prej nëntorit 2006 deri janar 2007. Ky raport përmban të gjeturat nga ky hulumtim.

Me 20 maj, 2006, Catholic Relief Services (CRS) ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me USAID të jetësoj projektin Partneritet Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PATH) me qëllim të mobilizimit dhe përforsimit të institucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile për luftimin e trafikimit. Në kuadër të këtij granti, CRS dhe Kosova Population Foundation (KOPF), në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, është planifikuar të jetësohet një kampanjë mediale, duke përdorur forma të shumfishta mediale përgjatë një periudhe të zgjatur kohore. Kjo kampanjë do të bazohet në hulumtimin formues të kryer nga Prism Research. Ky studim ofron informata më të hollësishme lidhur me njohuritë, informimin dhe perceptimet e tri audiencave në shënjestër të përmendura më herët. Bazuar në këtë hulumtim, kampanja mediale do të mundësoj formulimin e përcjelljes së porosisë në mënyrë më të fokusuar. Për më tepër, disa informata të mbledhura përgjatë studimit do të përdoret si të dhëna bazë për monitorim të mëtutjeshëm.

Sikurse u përmend më herët, ky hulumtim ka pasur në shënjestër tri grupe dhe qasja specifike e metodologjisë hulumtuese është dizajnuar për secilën nga këto grupe. Besohet se kjo është mënyra më e mirë për adresimin e kërkesave të hulumtimit, qëllimeve, çështjeve dhe pyetjeve më parë të identifikuar si të rëndësishme për secilën nga grupet specifike në shënjestër. Më poshtë është e përshkruar në detale qëllimet e hulumtimit për secilën nga grupet në shënjestër.

3. Objektivat

Audienca e Parë në Shënjestër – Popullsia e Përgjithshme

Pyetja e Përgjithshme Hulumtuese:

Ø Cilat janë njohuritë e përgjithshme të publikut dhe perceptimet për trafikimin?

Sferat e njohurive që do të ekzaminohen:

- Ø Pse përfundojnë vajzat/femrat si viktimat të trafikimit
- Ø Niveli i rëndësisë së këtij problemi për kosovarët
- Ø Kush/cilat institucione apo organizata mund të ndihmojnë viktimat e trafikimit
- Ø A janë kosovarët të vetëdijshëm për shenjat e mundura të viktimës së trafikimit
- Ø Cilat janë qëndrimet e kosovarëve drejt reintegrimit të viktimave në bashkësitë e tyre
- Ø Cilat janë përgjegjësitë e shoqërisë drejt viktimave të trafikimit

Audienca e Dytë në Shënjestër – Më të cenueshëm – Vajzat 14-18 vjeç

Pyetja e Përgjithshme Hulumtuese:

Ø Cili është niveli i informimit për trafikim dhe pasojat?

Sferat e njohurive që do të ekzaminohen:

- Ø Njohuritë për situatat që mund të shprijnë në trafikim
- Ø Si mund të gjej punë një femër e re
- Ø Me kë ajo konsultohet lidhur me ndonjë mundësi punësimi apo vendime tjera të rëndësishme në jetë
- Ø Si të mbrosh vetveten nga viktimizimi

- Ø Njohuritë për institucionet apo organizatat që mund t'i ndihmojnë viktimat
- Ø Cilat media kjo audiencë i shikon apo dëgjon
- Ø Mënyra më e mirë të shpërndarjes së informatave tek kjo audiencë

Audienca e Tretë në Shënjestër – Klientët e punëtorëve komercial të seksit

Pyetja e Përgjithshme Hulumtuese:

- Ø Cilat janë njohuritë e përgjithshme për trafikim dhe efektin e saj?

Sferat e njohurive që do të ekzaminohen:

- Ø Kush janë viktimat e prostitucionit me forcë (i detyruar, me dhunë)
- Ø Cilat janë shenjat e prostitucionit me forcë
Kush/cilat institucione apo organizata mund të kontaktohen kur hasin në viktimë të prostitucionit me forcë
- Ø Si ndihen ata lidhur me raportimin e këtyre rasteve në polici
- Ø Njohuritë mbi rrezikun që përfshin vizitat tek punëtorët e seksit komercial
- Ø Mënyra më e mirë të qaset kjo audiencë

4. Metodologjia

Ky projekt hulumtuese është kryer duke përdorur instrumente të ndryshme hulumtuese për secilën nga grupet në shënjestër sipas rendit specifik.

Më poshtë mund të gjeni përshkrimin e komponentëve kryesore hulumtuese, dhe rendi sipas të cilit komponentët e ndryshme janë përfunduar¹:

- Ø **Hulumtimi kuantitativ** – sondazh i popullsisë së përgjithshme të Kosovës dhe të vajzave të reja të moshës prej 14 deri 18 vjeç
- Ø **Hulumtimi kualitativ** – intervistat e thukëta me klientë të punëtorëve seksual dhe viktimave të trafikimit (të shpëtuara)

5. Përmbledhje

Sondazhi i popullsisë së përgjithshme dhe më të cënueshme (vajzat të moshës 14 deri 18 vjeç)

- Ø *Njohuritë për trafikimin e qenieve njerëzore*

Pothuajse e përgjithshme, respondentët nga të dy këto audiencia në shënjestër kanë dëgjuar për termin “trafikimi i qenieve njerëzore.” Pastaj, shumica e të dy grupeve kanë njohuri se trafikimi përfshin shfrytëzimin (eksploatimin) seksual. Megjithatë, trafikimi apo kontrolli mbi një person tjetër

¹ Shiko *Shtojca I* për përshkrim më të hollësishëm të metodologjisë hulumtuese

për qëllime të shfrytëzimit ka qenë shpesh e keqkuptuar se do të thotë prostitucion apo në disa raste edhe kontrabandim. Për shembull, më shumë se 65% të respondentëve nga popullsia e përgjithshme nuk kanë mundur të sqarojnë dallimin në mes të trafikimit dhe prostitucionit.

Ø *Viktimat e trafikuar – njohuritë dhe paragjykimet*

Respondentët nga të dy audiencat në shënjestër besojnë se viktimat më të shpeshta janë femrat dhe vajzat e reja dhe ngjashëm, ato konsiderohen se janë në rrezik më të madh. Kur janë pyetur pse femrat dhe vajzat e reja, përgjigjet më të shpeshta kanë qenë:

- Sepse kriminelët fitojnë shpejtë dhe lehtë përmes trafikimit, dhe
- Nuk kanë pasur njohuri apo kanë refuzuar të përgjigjen.

Respondentët në të dy sondazhet besojnë se femrat, personat me të rinj, personat që kanë status më të ulët ekonomik dhe arsimor, si dhe personat që nuk janë të informuar për këtë krim janë në rrezik më të madh të trafikohen. Përqindje signifikante të respondentëve, veçanërisht nga sondazhi i popullsisë së përgjithshme, kanë paragjykime, duke fajësuar viktimën për situatën në të cilën gjendet. Për shembull, përafërsisht një e treta e respondentëve fuqimisht apo deri diku pajtohet se edhe nëse dikush është i shtyre në prostitucion, ai person është i pamoralshëm. Ngjashëm, më shumë se një e treta pajtohet se viktima mund të ik (arratiset, shpëtoj) nëse ajo me të vërtetë dëshiron.

Ø *Trafikimi në Kosovë*

Respondentët nga të dy sondazhet pajtohen se trafikimi është i përhapur si në Kosovë ashtu edhe në bashkësinë ku ata jetojnë. Mirëpo, shumë kosovar nga të dy sondazhet nuk njohin se Kosova është vend i origjinës së femrave të trafikuar. Televizioni është burimi primar i informimit lidhur me problemet e tyre, përcjellur nga mediat tjera dhe miqtë. Personat e anketuar janë të brengosur me praninë dhe shtrirjen e trafikimit në bashkësinë e tyre.

Ø *Përgjegjësitë për shtrirjen dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore*

Mendimet e respondentëve kanë qenë fuqishëm të ndara në çështjen se kush është përgjegjës për nivelin e trafikimit në Kosovë. Së pari ata fajësojnë trafikuesit, pastaj autoritetet dhe policinë. Dy të fundit fajësohen se nuk janë duke ndërmarr mjaft hapa për luftimin e trafikimit. Një mënyrë që të luftohet trafikimi është informimi i popullsisë dhe shumica e atyre që janë anketuar besojnë se nuk ka informata të mjaftueshme për këtë çështje.

Ø *Angazhimi personal në luftimin kundër trafikimit*

Pjesë e madhe e respondentëve nga të dy sondazhet raportojnë se do të ndanin informatat që i kanë lidhur me trafikimin, më së shpeshti me policinë. Mirëpo, është e njohur se opinioni publik nuk transformohet gjithmonë në veprim.

Ø *Viktimat e mëhershme të trafikimit – reintegrimi social dhe ndihma*

Respondentët më së shumti pajtohen se viktimat e trafikimit mund të reintegrohen dhe se ata duhet të ndihmohen nga qeveria, policia dhe shërbimet sociale. Kjo mund të përfshij ndihmë profesionale psiko-sociale, këshillim apo rehabilitim, akomodim të sigurt dhe ushqim dhe mbrojtje të identitetit.

Vajzat e reja kanë theksuar se ndihma e familjes është vendimtare në reintegrimin social të viktimës.

Ø *Prirja për sjellje të rrezikshme*

Respodentët vajza të reja kanë ofruar përgjigje të ndryshme kur janë pyetur nëse janë në rrezik të trafikohen. Gati gjysma kanë theksuar se ato besojnë se janë në rrezik. Është shqetësuese se një numër i rëndësishëm i tyre nuk kanë njohuri se si të mbrohen nga trafikantët e qenieve njerëzore. Vajzat të cilat kanë theksuar se kanë njohuri se si të mbrohen kanë spikatur se këtë e bëjnë përmes përzgjedhjes së miqve dhe grupeve sociale me të cilat shoqërohen. Mirëpo, pjesa kualitative e këtij hulumtimi shpalos se një numër i viktimave të trafikimit janë grabitur nëpërmjet veprimeve të njerëzve të cilëve ato i kanë njohur dhe i kanë besuar. Vajzat e reja kanë nevojë të informohen gjerësisht për rreziqe.

Viktimat e trafikimit

Ø *Jeta para se të trafikohen*

Para se të trafikohen, shumica e femrave kanë jetuar me familjet e veta – ato më të reja me prindërit e tyre ndërsa ato më të moshuara të martuara me partnerët e tyre dhe fëmijët. Situata e tyre financiare në shumicën e këtyre familjeve ka qenë e vështirë. Anëtarët e familjes kanë qenë të papunësuar dhe kushtet e jetesës në viset rurale, prej nga disa nga vajzat vijnë, kanë qenë jashtëzakonisht të varfra me mundësi shumë të vogla punësimi.

Ø *Të qenurit e trafikuar dhe jeta si viktimë*

Ka mënyra të ndryshme si trafikantët e qenieve njerëzore joshin viktimat e tyre. Njëra mënyrë të joshen të rejtat është përmes ofertës për punësim. Tjetra, sikurse është përmendur më herët është përmes njerëzve që vajzat/femrat i njohin. Mënyrat se si trafikantët e qenieve njerëzore i trajtojnë viktimat e tyre shpesh janë jashtëzakonisht të egra. Shembujt e ofruara nga respodentët përfshijnë kidnapimet brutale, dhunimet, dhe konsumimi me forcë i alkoolit (dhe më e mundura të narkotikëve, sipas intervistave me klientët e punëtorëve të seksit komercial).

Ø *Lidhur me kohën që respodenti ka kaluar si viktimë e trafikimit*

Të gjitha nga vajzat e intervistuar kanë qenë seksualisht të shfrytëzuara. Disa po ashtu kanë punuar si punonjës në lokalet ku është shërbyer ushqimi (klube të natës, restorante, etj.). Prism ka pyetur viktimat e shpëtuara se kush kanë qenë klientët “e zakonshëm” që kanë frekuentuar këto vende. Vajzat dhe femrat kanë theksuar se klientët kanë përfshirë meshkuj të moshave të ndryshme, që nga moshat e reja deri tek ato të moshës së mesme. Disa kanë raportuar të kenë pasur vetëm klientë shqiptar të Kosovës, ndërsa të tjerat kanë përmendur nacionalitete të ndryshme. Viktimat e shpëtuara supozojnë, dhe disa deklarojnë me siguri, se emërtues i përbashkët i të gjithë klientëve ka qenë pasuria e tyre. Klientët e punëtorëve të seksit të intervistuar në kuadër të këtij projekti hulumtues, janë pajtuar me këtë vlerësim.

Ø *Koha e kaluar pasi që janë liruar*

Është njohuri e përgjithshme se viktimat e shpëtuara të cilat kanë qenë prostituta shpesh janë të stigmatizuara dhe të përjashtuara nga shoqëria, dhe kështu ka qenë rasti me disa nga femrat e

intervistuar. Është posaçërisht brengosëse se këto vajza mund të braktisen nga familjet e tyre, gjë që mund të shpie sërish deri tek ri-trafikimi.

Tash pasi që ato janë shpëtuar, vajzat/femrat shpresojnë për jetë më të mirë dhe të ndritshme. Në vartësi prej moshës së tyre, pritjet e tyre zakonisht përfshijnë përfundimin e shkollimit dhe krijimin e familjes. Ato shpresojnë të përkrahen nga institucionet dhe organizatat relevante në proces të rehabilitimit, të gjejnë punësim legal, dhe t'ju ofrohet mundësia të jetojnë jetë normale.

Klientët e punëtorëve të seksit komercial

Ø *Në përgjithësi për trafikimin*

Meshkujt që kanë pasur marrëdhënie seksuale me prostitutë gjatë vitit të fundit kanë ndarë shumë nga opinionet e njëjta lidhur me trafikimin sikurse popullsia e përgjithshme. Shumica kanë bërë lidhjen e termit “trafikim i qenieve njerëzore” me aktivitet kriminal, kryesisht të lidhur me femra dhe vajza që përdoren për prostitucion.

Disa responentë i kanë besuar përgjegjësinë që të luftoj trafikimin shoqërisë në përgjithësi, duke argumentuar se qytetarët duhet të luftojnë kundër saj duke bashkëpunuar me zbatim të ligjit. Klientët besojnë se prania e trafikimit është njohuri e përgjithshme andaj bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe zbatuesve të ligjit mund të kontribuoj në masë të madhe në luftimin e këtij problemi. Të tjerët kanë përcaktuar përgjegjësinë tek organizatat dhe institucionet specifike, siç është drejtësia (gjyqësori) dhe policia.

Ø *Trafikimi në Kosovë*

Shumica pajtohen se trafikimi është prezent në Kosovë. Edhe pse një numër i tyre vizitojnë shtëpitë publike, ata kanë deklaruar se kanë mësuar për trafikimin përmes mediave – në shumicën e rasteve përmes televizionit dhe gazetave. Të ashtuquajturat “shtëpi publike” (bordele) vizitohen nga meshkuj të grupeve etnike të ndryshme, përfshirë njerëz të vendit dhe ndërkombëtar. Lidhur me moshën e klientëve, shumica e responentëve thonë se ndryshon, përderisa disa nga ata pohojnë se klientët përfshijnë shumë meshkuj të ri dhe të paarsimuar.

Responentët adoptojnë qasje të ndryshme në përshkrimin e vajzave/femrave që punojnë në këto vende. Disa fokusohen në tipare fizike, përderisa të tjerët ofrojnë informata lidhur me përkatësinë e tyre etnike, moshën, arsimimin dhe prapavijën familjare. Ata pajtohen se prostitutat vijnë nga familjet e varfra, zakonisht janë të paarsimuara, nuk kanë eksperiencë të mëhershme pune, dhe që janë duke tentuar të fitojnë para. Zakonisht, ato janë shumë të reja. Disa thonë se shumica vijnë nga vendet e huaja, siç janë Bullgaria, Moldavia, Shqipëria dhe Rusia, mirëpo një numër signifikant janë po ashtu nga Kosova. Disa nga responentët ngatërrojnë trafikimin me prostitucionin e vullnetshëm (me dashje).

Ø *Përjetimet personale*

Siç është cekuar më herët, të gjithë responentët kanë pasur ndonjë përjetim me prostituta dhe janë të vetëdijshëm për vendet në komunitetin e tyre ku ofrohen shërbimet seksuale. Opinionet e responentëve për këto vende ndryshojnë. Përderisa disa kanë qenë shumë indiferent për këto vende, të tjerët kanë kritikuar ashpër ekzistimin e shtëpive publike.

Ø Disponueshmëria e informatave lidhur me trafikim

Respodentët kanë opinione të ndryshme lidhur me disponueshmërinë e informatave për trafikim. Përderisa disa thonë se ka informatat të mjaftueshme që ofrohen në publik, të tjerët besojnë të kundërtën. Një respodent i cili beson se publiku nuk është mjaft i informuar ka theksuar se vëmendje të veçantë duhet të jepet në arsimimin e popullatës së re. Në përgjithësi, respodentët pajtohen se më shumë informata lidhur me trafikim duhet të ofrohet në media.

6. Të gjeturat – Sondazhi i popullsisë së përgjithshme

Përshkrimi i mostrës

Tabela 01. Përshkrimi i mostrës (1)

		Frekuenca	Përqindja
GJINIA	Mashkull	264	53.8%
	Femër	227	46.2%
MOSHA	16-25	158	31.6%
	26-35	121	24.2%
	36-45	97	19.4%
	46-55	58	11.6%
	56-65	43	8.6%
	66+	23	4.6%
STATUSI I PUNËSIMIT (Total)	Punësuar	145	29.0%
	Papunësuar	355	71.0%
STATUSI I PUNËSIMIT (Meshkuj)	Punësuar	108	40,9%
	Papunësuar	156	59,1%
STATUSI I PUNËSIMIT (Femra)	Punësuar	36	15,9%
	Papunësuar	191	84,1%
ARSIMIMI (vitet e shkollimit të përfunduara)	Nuk ka përfunduar shkollën fillore	43	8.6%
	Përfunduar shkollën fillore	114	22.8%
	Përfunduar shkollën e mesme	261	52.2%
	Shkolla e lartë	48	9.6%
	Diplomë universiteti	32	6.4%
	Shkallë e tretë/Doktoratë	2	0.4%
GRUPI ETNIK	Shqiptar	445	89.0%
	Serb	51	10.2%
	Boshnjak	1	0.2%
	Rom	2	0.4%
	Të tjerë	1	0.2%

Pesë qind responentë kanë marrë pjesë në këtë hulumtim. Nga tabela më lartë (*shiko Tabela 01.*), struktura gjinore e mostrës ka qenë pothuajse e barabartë – 53.8% të responentëve kanë qenë meshkuj dhe 46.2% kanë qenë femra. Më tej, 31.6% të mostrës kanë qenë prej 16 deri 25 vjeç, 24.2% kanë qenë 26 deri 35, 19.4% kanë qenë 36 deri 45, 11.6% kanë qenë 46 deri 55, 8.6% kanë qenë 56 deri 65, dhe 4.6% kanë qenë më të moshuar se 65 vjeçar. Sa i përket statusit të punësimit të responentëve, gati tre të katërtat kanë qenë të papunësuar (71.0%). Femrat kanë qenë më rrallë të punësuar sesa meshkujt.

Sa i përket të arriturave në arsimim të mostrës, 8.6% nuk e kanë përfunduar shkollën fillore, 22.8% e kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 52.2% kanë përfunduar shkollën e mesme, 9.6% kanë përfunduar shkollën e lartë², 6.4% kanë diplomuar në studimet universitare, dhe 0.4% kanë shkallë të tretë apo doktoratë. Ngjashëm me të dhënat demografike të Kosovës, shumica e responentëve janë shqiptarë etnik (89.0%) përderisa 10.2% të responentëve janë serb etnik dhe 0.8% i takojnë komunitetit tjetër minoritar.

Tabela 02. Përshkrimi i mostrës (2)

		Frekuenca	Përqindja
ZONË	Shumicë shqiptare	450	90.0%
	Shumicë serbe	50	10.0%
RAJONI	KFOR Francez	105	21.0%
	KFOR Britanez	135	27.0%
	KFOR Amerikan	85	17.0%
	KFOR Gjerman	85	17.0%
	KFOR Italian	90	18.0%
	Urban	330	66.0%
LLOJI I VENDBANIMIT	Rural	170	34.0%
SITUATA SOCIO-EKONOMIKE	Ekonomikisht jemi mirë	124	24.8%
	Kemi burime për argëtim / udhëtime	69	13.8%
	Vështirë i paguajmë të gjitha faturat	121	24.2%
	Kemi të holla vetëm për ushqim dhe strehim	119	23.8%
	Nuk kemi të holla të mjaftueshme çdo muaj	60	12.0%
	Nuk di/Nuk dëshiron të përgjigjet	7	1.4%


Shpërndarja e responentëve sipas rajoneve – sikurse që është paraqitur lartë në tabelë – ka qenë më herët e planifikuar. Dy të tretat e responentëve janë nga viset urbane dhe një e treta nga viset rurale. Sa i përket statusit socio-ekonomik të pjesëmarrësve, gati një e katërta (24.8%) theksojnë se ekonomikisht janë mirë, përderisa 13.8% kanë të holla të mjaftueshme për argëtim dhe udhëtim. Responentët e tjerë kanë përshkruar situatën e vet socio-ekonomike pak a shumë si të vështirë.

² Shkolla e lartë – Dy apo tre vjeçar pas shkollës së mesme

Njohuritë mbi trafikimin

Responentët së pari janë pyetur nëse kanë dëgjuar për termin “trafikim i qenieve njerëzore.” Siç mund të shihet (*shiko Grafi 01.*), shumica dërrmuese (91%) njohin termin apo kanë dëgjuar lidhur me të. Pasi që trafikimi kohëve të fundit është cilësuar si problem social dhe ka tërhequr vëmendje të madhe në media, rezultatet të tilla kanë qenë të pritshme.

Grafi 01. A keni dëgjuar ndonjëherë për termin “trafikim njerëzor”? (N=500)




Mirëpo, pyetjet shitesë në këtë lëmi kanë zbuluar dallime statistikisht të rëndësishme³ në njohuritë e popullsisë për çështjet e trafikimit. Këto dallime duket të jenë të varura, në nivelin e arsimimit të responentit. Ata me nivel më të lartë të arsimimit duket të kenë më shumë informata për këto çështje. Duke marrë parasysh madhësinë e mostrës dhe madhësinë e nën-mostrave të niveleve të ndryshme të arsimimit, rezultatet e cekura më lartë mund të trajtohen si indikator dhe të shikohen si trend për të cilin nevojitet gjurmim më i thellë.

Responentët që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e kaluar më pas janë pyetur të japin shembuj të mënyrave se si trafikantët shfrytëzojnë viktimat e tyre. Atyre nuk i janë ofruar përgjigjet dhe përgjigje të shumfishta janë incizuar. Siç mund të vërehet (*shiko Grafi 02.*), shumica e kosovarëve pjesëmarrës në këtë hulumtim (83.1%) janë të informuar për shfrytëzimin seksual, në fakt prostitucionin. Për më tepër një numër i rëndësishëm i responentëve kanë përmendur forma të tjera të shfrytëzimit, siç është heqja e ndonjë organi për transplantim (37.9%), robëria (31.5%), punë e paguar ulët (31.3%), kërkim lëmoshë e organizuar (28.8%), përdorimi i viktimave të trafikimit për aktivitete kriminale (22.8%), adoptime ilegale (18%) etj.

³ Përgjatë raportit, vetëm dallimet statistikisht të rëndësishme në mes të variablave që janë krahasuar janë përmendur. Dallimi me 5% apo më gjasë më të vogël i përfshirjes sipas rastit, në fakt, vlera p baras apo më e vogël se 0.05, është konsideruar si statistikisht e rëndësishme.

Respondentët me nivel më të lartë të arsimimit kanë spikatur njohuri më të mëdha për këtë çështje. Respondentët me nivel më të ulët të arsimimit kanë shfaqur njohuri më të pakta për mënyrat se si viktimat shfrytëzohen. Për më tepër, respondentët nga viset rurale kanë më pak gjasa të njohin shembuj specifik të shfrytëzimit.

Grafi 02. A e dini si i shfrytëzojnë trafikuesit e njerëzve viktimat e tyre – a mund të më jepni ndonjë shembull? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=455)



Pasi që trafikimi shpesh identifikohet me prostitucion, Prism ka pyetur respondentët të shpjegojnë dallimin në mes të këtyre dyjave në bazë të fjalëve të veta (*shiko Tabela 03.*). Interesant për t'u veçuar, më shumë se gjysma e respondentëve (65.6%) nuk kanë mundur apo nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Kjo pasiguri dhe ky ngatërrim lidhur me dallimin në mes të prostitucionit dhe trafikimit është e gjetur konsistente përgjatë tërë hulumtimit. Një në dhjetë respondentë (10.2%) definojnë trafikimin si veprim i dhunshëm përderisa theksojnë se prostitucioni mund të jetë me dashje (vullnetarisht). Diçka më pak se një në dhjetë respondentë (9.2%) kanë theksuar se këto të dyja janë të njëjta – të dyja përfshijnë tentativa të përfitimit financiar duke përdorur dhunën.

Tabela 03. A mund të më tregoni me fjalë tuaja dallimin në mes të trafikimit dhe prostitucionit?
(Pyetje e hapur) (N=500)


Përgjigjet	%
Trafikimi është kur dikush pëson shtytje, përderisa prostitucioni është (mund të jetë) sipas dëshirës	10.2
Ato janë njëjtë (të ngjashme); në të dyja rastet përdoret dhuna në mënyrë që t'i shtyj njerëzit të bëjnë diçka për para	9.2
Trafikimi është shitja e qenieve njerëzore, prostitucioni është kur dikush është i shtyre (kundër dëshirës) nga kriminelët të ofroj shërbime seksuale për para	6.4
Trafikimi zakonisht ndodh për shitjen e organeve njerëzore, dhe prostitucioni për shfrytëzim seksual dhe përfitime financiare	3.4
Trafikimi mund të ndodh me çfarëdo prone (përfshirë edhe njerëzit); prostitucioni vetëm me femra	1.8
Prostitucioni është pasojë e trafikimit	1.2
Trafikimi bëhet për përfitime tjera, prostitucioni vetëm për shërbime seksuale	1.2
Trafikimi kur udhëton (ilegalisht) përgjatë kufijve, prostitucioni është ofrim i shërbimeve seksuale për para	1.0
Trafikimi është kur dikush i shet të tjerët, prostitucioni është kur dikush e shet veten	0.8
Trafikimi është kur dikush trafikohet, përderisa prostitucioni është kur dikush paguhet me të holla	0.6
Trafikimi kur (vajzat) kidnapohen, prostitucioni është kur ato shkojnë (ofrojnë shërbime për) pas parave	0.6
Trafikimi është një lloj i sjelljes kur je i shtyre me dhunë, përderisa prostitucioni është me vetëdëshirë por pa mundësi tjera	0.6
Tjetër	7.4
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	65.6

Viktimat e trafikimit – njohuritë dhe paragjykimet

Trafikimi i qenieve njerëzore shpesh keqkuptohet. Trajtimi nga ana e mediave i këtij problemi kompleks shpesh është sensacional, duke zbuluar vetëm informatat më tronditëse. Kjo qasje duket të përforcoj paragjykimet ekzistuese lidhur me viktimat e trafikimit dhe të atyre që janë në rrezik. Viktimat e trafikimit shpesh janë të stigmatizuara dhe të fajësuara për rrethanat në të cilat ato gjenden. Për këtë arsye, ka qenë me rëndësi të kuptohet çfarë njohurish kanë kosovarët për viktimat e trafikimit dhe sa fuqishëm paragjykimet ndikojnë në qëndrimet e tyre. Informata më të hollësishme lidhur me njohuritë e kosovarëve për trafikimin e qenieve njerëzore mund të përdoren si bazë për ndërtimin e strategjisë informative me qëllim të parandalimit të trafikimit. Lidhur me këtë, njëra prej pyetjeve të para që i është parashtruar respondentëve ka qenë kush janë viktimat e trafikimit? Siç mund të shihet (*shiko Grafë 03.*), gati gjysma e respondentëve (48.2%) besojnë se

shumica e viktimave janë femra. 31.8% të tjerë besojnë se vajzat e reja janë më të cenueshme, përderisa 11.8% spikasin fëmijët si viktime të trafikimit.

Grafi 03. Kush mendoni se janë më së shpeshti viktime të trafikimit njerëzor? (N=500)



Responentët pastaj janë pyetur të sqarojnë arsyen pse besojnë së këto grupe janë në rrezik më të madh. Prism ka analizuar vetëm përgjigjet me frekuencë më të lartë në këtë pyetje – për femra, vajza të reja dhe fëmijë. Tabela në vijim (*shiko Tabelën 04.*) liston përgjigjet e responentëve në këtë përgjigje. Siç mund të vërehet, numër signifikant i responentëve, në mes 25 dhe 30%, nuk kanë pasur njohuri apo nuk kanë dashur të sqarojnë arsyet e tyre pse nuk e shfaqin mendimin e tyre. Ata të cilët janë përgjigjur janë fokusuar në trafikantët më parë se sa në arsyet pse këto grupe janë në rrezik më të madh. Më shumë se 40% të responentëve besojnë se trafikantët e qenieve njerëzore janë pikërisht ata që e rrisin rrezikun për femra, vajza të reja dhe fëmijë. Responentët kanë theksuar se trafikantët janë persona të dëmshëm, që kanë dëshirë të fitojnë të holla shpejtë dhe lehtë, etj.


Disa responentë kanë sqaruar se kushtet e pafavorshme socio-ekonomike, varfëria dhe dëshira të sigurojnë një jetë më të mirë janë disa nga arsyet pse grupet e cekura më lartë janë në rrezik më të madh. Një numër i vogël i responentëve kanë atribuuar shkaqet faktit se femrat dhe vajzat e reja janë të buta dhe të pafuqishme.

Tabela 04. Sipas jush, pse trafikohen femrat/vajzat e reja/fëmijët? (Pyetje e hapur) (N=495)

	Femra (N=241)	Vajzat e reja (N=159)	Fëmijët (N=59)
Përgjigjet			
Kriminelët/njerëzit e ligë/trafikanët dëshirojnë të fitojnë para shpejtë dhe lehtë	47,7	47,8	39,0
Sepse vajzat janë të buta dhe pafuqishme	1,7	3,8	0,0
Prostitucion	2,9	5,7	1,7
Sepse janë naive	2,1	3,1	0,0
Eshte lehtë që ato të mashtrohen dhe shfrytëzohen	0,0	0,6	0,0
Transplantim të organeve	0,4	1,9	5,1
Viktimat trafikohen kundër dëshirës së tyre	0,0	0,6	0,0
Varfëria	4,6	3,1	1,7
Sepse ato shiten tek dikush tjetër (pronarët e lokaleve, etj.)	1,2	3,8	3,4
Ato kërkojnë jetë më të mirë	1,2	1,3	1,7
Shfrytëzim	1,7	1,3	1,7
Nuk janë të kujdesshme	0,0	0,6	3,4
Mungesa e kujdesit prindëror	0,0	0,6	0,0
Nuk kanë rrugëdalje tjetër (zgjidhje)	0,4	0,0	0,0
Janë grupi më i rrezikuar	0,4	0,0	10,2
Mungesa e arsimimit	0,8	0,0	0,0
Martesa	0,4	0,0	0,0
Mungesa e sundimit të ligjit	0,4	0,0	0,0
Mosfunksionimi i sistemit juridik	0,8	0,0	0,0
Punësim i fëmijëve	0,4	0,0	0,0
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	32,8	25,8	32,2

Perceptimi se cilat grupe të popullsisë janë më të ekspozuara ndaj rrezikut më të madh nga trafikimi është në linjë të njëjtë me vlerësimin e respondentëve se kush janë viktimat. Respondentët njohin femrat, vajzat e reja, dhe fëmijët si viktimat më të shpeshta të trafikantëve të qenieve njerëzore dhe në të njëjtën kohë besojnë se këto tri grupe, femrat (49.8%), vajzat e reja (34.8%), dhe fëmijët (12%), janë në rrezik më të madh të trafikohen (*shiko Grafi 04.*).

Grafi 04. Kush mendoni se është në rrezikun më të madh të trafikohet? (N=500)



Pyetja në vijim ka identifikuar perceptimin e kosovarëve se cilat grupe janë në rrezik më të madh të trafikohen (*shiko Tabela 05.*). Po ashtu ka shpalosur disa perceptime paragjyquese për viktimat.

Shumica e respondentëve pajtohen se femrat (90.4%) janë në rrezik më të madh sesa meshkujt (1.2%), përderisa 8% të respondentëve kanë pohuar se rreziku është i njëjtë për të dy gjinitë. Më tej, fëmijët dhe të rinjtë (77.4%) besohet se janë në rrezik më të madh se sa personat e moshuar (3.2%), përderisa secili i pesti respondent (18.8%) beson se mosha nuk është faktor vendimtar. Këto opinione më e mundura reflektojnë faktin se shumica e viktimave të raportuara janë femrat e reja të shfrytëzuara seksualisht. Respondentët po ashtu besojnë se personat me status më të ulët ekonomik (61.4%) kanë më shumë gjasa të trafikohen se sa personat e pasur (6.2%). Mirëpo, është me rëndësi të ceket se 29.8% të respondentëve besojnë se nuk ka korrelacion në mes të statusit ekonomik dhe rrezikut. Situata është e ngjashme në rast të arsimit, pasi që 59% të respondentëve besojnë se ata me nivel të arsimit më të ulët janë në rrezik më të lartë të trafikohen përderisa 35.2% besojnë se rreziku nuk varet prej nivelit të arsimit. Opinion tjetër i shfaqur nga respondentët është se sa më shumë informata dikush ka lidhur me trafikimin, më pak ka mundësi që ata të trafikohen. Personat e përfunduar (66.8%) besohet se janë në rrezik më të madh se sa ata që kanë informata të duhura (0.4%). Mirëpo, rreth çereku i respondentëve (25.4%) besojnë se niveli i informatave nuk ka ndikim. Gati gjysma e respondentëve (48.6%) besojnë se rreziku është i njëjtë po që se dikush jeton në viset urbane apo rurale. Një numër i rëndësishëm i respondentëve (48.8%) beson se ata me nivel më të ulët të inteligjencës janë në rrezik më të madh edhe pse më shumë se 40% kanë shfaqur mendimin se rreziku është i njëjtë. Përgjigjet në pyetjen e radhës kanë shpalosur ndjenja negative lidhur me viktimat. Gati gjysma e respondentëve (48.8%) besojnë se personat e pamoralshëm janë më shumë të trafikohen se sa personat e moralshëm. Kjo duket të tregojë se respondentët vendosin një dozë të fajit të qenurit e trafikuar në vet viktimiten.

Tabela 05. Kush mendoni se është në rrezikun më të madh të trafikohet? (N=500)⁴

⁴ ND/R(P) – Nuk e di/Refuzon të përgjigjet

Rrezik më të madh %		Rreziku është i njëjtë	ND/R	Rrezik më të madh %	
Femër	90,4	8	0,4	1,2	Mashkull
Fëmijët dhe të rinjtë	77,4	18,8	0,6	3,2	Personat e moshës së mesme dhe të vjetrit
Më të varfrit	61,4	29,8	2,6	6,2	Më të pasurit
Të paarsimuarit	59	35,2	3,8	2	Të arsimuarit
Të pamoralshmit	48,8	41,2	7,2	2,8	Të moralshmit
Më pak inteligjent	48,8	40,4	8,8	2	Më shumë inteligjent
Të painformuar	66,8	25,4	7,4	0,4	Të informuar
Rural	24,2	48,6	10,4	16,8	Urban

Tjetër, Prism ka pyetur respondentët të shfaqin mendimet e tyre lidhur me disa deklaratat të bëra për trafikim. Përgjigjet duket të shpajnë në një përfundim se numër i rëndësishëm i respondentëve janë të ndikuar (njëanshëm) kundër viktimave të trafikimit. Më shumë se një e treta e të pyeturve (36.8%) besojnë se viktimat mund të arratisen nëse njëmend do të dëshironin (*shiko Tabelën 06.*). Kjo duket të shënoj se respondentët besojnë se viktimat kanë zgjedhur të pranojnë situatën në të cilën gjenden. Më shumë se 30% besojnë se viktimat e trafikimit kanë njohuri se në çfarë janë duke u futur. Nëse shprehemi ndryshe, kjo duket të tregoj se viktimat konsiderohen përgjegjëse për shkatërrimin që e pësojnë.

Opinionet e respondentëve lidhur me moralin e vajzave të trafikuar të cilat bëhen prostituta ndryshojnë, sepse 29.4% konsiderojnë se këto vajza janë të pamoralshme përdërisa më shumë se gjysma beson të kundërtën. Në një pyetje të ngjashme, më shumë se një e treta e respondentëve (36.6%) besojnë se prostitutat janë të pamoralshme edhe nëse janë të shtyra të punojnë si punëtoreshë të seksit. Në anën tjetër, tre të katërtat e respondentëve pajtohen se dikush që përdor shërbime të prostitutave është i pamoralshëm. Gati gjysma e respondentëve (47.6%) beson se vajzat më pak inteligjente janë më shumë të prirura të shoqërohen apo ngatërrohen me kodosh (makro). Supozim i arsyeshëm i më pak se gjysmës së respondentëve (46.5%) është se vajzat bëhen viktime sepse ato kanë nevojë për të holla.

Edhe nëse respondentët ka përvetësuar nocione të mëhershme lidhur me viktimat, më shumë se 80% besojnë se këto femra dhe vajza janë viktime dhe se 89% besojnë se ato meritojnë ndihmën e qeverisë. Përgjegjësinë e plotë për trafikim i përcaktohet trafikantëve. Në fund të serisë së këtyre pyetjeve, Prism ka kërkuar nga respondentët të vlerësojnë nivelin e rrezikut nga trafikimi që ata ndiejnë se ekspozohen. Shumica (62.6%) kanë theksuar se kjo nuk mund t'i ndodh atyre.

Tabela 06. Tani do t'ju lexoj një listë me pohime dhe dëshiroj që ju të më tregoni nëse pajtoheni fuqimisht, deri diku pajtoheni, deri diku nuk pajtoheni apo fuqimisht nuk pajtoheni me secilën nga deklaratat që do t'ju lexoj. (N=500)

Pohimet/përgjigjet	Fuqimisht pajtohet	Deri diku pajtohet	Deri diku nuk pajtohet	Fuqimisht nuk pajtohet	ND/R
Njerëzit të cilët përfshihen në trafikim mund lehtë të ikin nëse me të vërtetë dëshirojnë.	19	17,8	21,4	27,4	14,4
Viktimat e trafikimit kanë njohuri se në çfarë janë duke e futur veten.	10,6	19,6	22,6	36,6	10,6
Vajzat të cilat trafikohen janë të pamoralshme sepse ato janë bërë prostituta (punëtore të seksit komercial).	5,2	24,2	29	27,2	14,4
Viktimat e trafikimit meritojnë ndihmën e qeverisë.	69,6	19,4	4,6	1,2	5,2
Vajzat të cilat janë të trafikuar duhet të jenë paksa të marra të shoqërohen me makro (kodosh, rrufjan).	20,6	27	18,6	9	24,8
Vajzat të cilat janë të trafikuar përfshihen në trafikim sepse atyre ju nevojiten të hollat dhe nuk kanë mënyrë tjetër si t'i fitojnë.	15	31,6	20,8	21,2	11,4
Vajzat të cilat janë të trafikuar janë viktima; është faji i trafikantëve të cilët kryejnë krim.	63,8	19,8	5,4	1,8	9,2
Përdorimi i shërbimeve seksuale nga punëtorët e seksit është i pamoralshëm.	60,2	15,8	5,8	3,8	14,4
Edhe pse dikush mund të jetë e shtyrë në prostitucion, ajo (punëtorja e seksit) është e pamoralshme	13,8	22,8	22,8	17,8	22,8
Unë kurrë nuk do të mund të isha i/e trafikuar.	54,8	7,8	7,2	8,4	21,8

Dukshëm më shumë se gjysma e respondentëve nuk kanë mundur apo kanë refuzuar të përgjigjen në pyetjen se si mund të njihen viktimat e trafikimit. Disa respondentë (11.2%) ka pohuar se viktimat e trafikimit nuk mund të njihet përveç nëse ai/ajo nuk jep informacionin se është i/e trafikuar apo nëse kjo informatë vjen nga ndonjë burim tjetër. Rreth një në dhjetë respondentë (10.6%) besojnë se viktimat mund të njihet në bazë të sjelljes së personit të dyshuar, mirëpo nuk kanë qenë në gjendje të karakterizojnë se për çfarë sjellje bëhet fjalë. Numër më i vogël i respondentëve (5.2%) kanë pohuar se viktimat e trafikimit mund të njihet sipas mënyrës se si ata/ato duken. Përgjigjet tjera, më rrallë të cekura janë të paraqitura në tabelën më poshtë (shiko Tabela 07).

Tabela 07. Si mund ta dimë nëse një person është viktimë e trafikimit? (Pyetje e hapur) (N=500)


Përgjigjet	%
Nuk besoj se mund ta dimë/njohim	11.2
Në bazë të sjelljes (sillet çuditshëm)	10.6
Duke e shikuar atë (dukja e përgjithshme)	5.2
Rraskapitje fizike dhe mentale	2.0
Duken të frikësuar (traumatizuar)	1.8
Nëse ajo merret përkundër dëshirës	1.6
Shenja (mavijosje) në trup	1.2
Braktis familjen (shtëpinë)	1.2
Introverte (qëndron në një vend të caktuar kohë të gjatë)	1.0
Nuk flet gjuhën e vendit (gjuhë tjera)	0.8
Nëse ai person kërkon të holla	0.6
Kur një person është brengosur dhe i vetmuar	0.6

Ndryshon nga njerëzit tjerë	0.6
Nëse punon në lokal nate	0.6
Tjetër	2.4
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	58.2

Trafikimi në Kosovë


Grupi i tjetër i pyetjeve ka qenë i dizajnuar të mbledh informata lidhur me perceptimet e respondentëve për shtrirjen e trafikimit të qenieve njerëzore në mbarë Kosovën, si dhe në bashkësinë ku ata jetojnë. Respondentët pajtohen (*shiko Grafi 05.*) se trafikimi është prezent në Kosovë (91.8%).

Grafi 05. Sipas mendimit tuaj, a është problemi i trafikimit njerëzor prezent në Kosovë? (N=500)




Respondentët që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e kaluar janë pyetur të diskutojnë arsyet dhe faktorët që rezultojnë në shtrirjen e trafikimit në Kosovë (*shiko Grafi 06.*). Respondentëve nuk i janë ofruar kategoritë e përgjigjeve dhe përgjigje të shumëfishta kanë qenë të lejuara. Përgjigjet e përzgjedhura nga shumica, apo 58.9% të respondentëve ka qenë jostabiliteti socio-ekonomik në Kosovë. 39.3% të respondentëve të tjerë besojnë se trafikimi ka filluar në Kosovë pas dëshirës së fortë të fitohen të hollat *shpejtë*. Rreth një e treta të respondentëve (34%) besojnë se prezenca ndërkombëtare në Kosovë kontribuon në prezencën e trafikimit në Kosovë. Prevalenca e imoralitetit në Kosovën e pas luftës është përmendur nga 29.8% të respondentëve; përderisa një përqindje diçka më e ulët (29.1%) besojnë se kjo është për shkak të fazës transitore me të cilën Kosova po ballafaqohet. Në fund, më shumë se çereku i respondentëve (28.9%) besojnë se krimi i organizuar është shkaktar i rëndësishëm.

Grafi 06. Sipas mendimit tuaj, cilat janë arsyet dhe faktorët që e kanë sjellë trafikimin në Kosovë? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=459)




Kur janë pyetur për burimet e informatave lidhur me këtë çështje, shumica e respondentëve kanë përmendur mediat e ndryshme që ata i kanë në dispozicion. Siç mund të parashihet (*shiko Grafi 07.*) shumica dërrmuese e respondentëve (94.3%) kanë dëgjuar për trafikimin përmes televizionit. Më shumë se 40% të respondentëve (41.7%) kanë kuptuar për këtë problem prej gazetave apo revistave, përderisa një përqindje diçka më e vogël (38.2%) kanë pranuar informata prej programeve në radio. 14.4% të respondentëve të tjerë kanë dëgjuar për trafikimin e qenieve njerëzore prej miqve dhe/apo farefisit.

Grafi 07. Në çfarë mënyre ke dëgjuar për problemin e trafikimit njerëzor në Kosovë? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=459)




Pyetja e ardhshme ka qenë për pozitën e Kosovës në trafikimin e qenieve njerëzore (*shiko Grafi 08.*). A është territori vend transit, destinacion apo origjinë, apo madje kombinim i këtyre faktorëve? Shumica e respondentëve (71.2%) e njohin Kosovën si vend transit për trafikim. Megjithatë, vetëm 32.8% kanë deklaruar se Kosova është gjithashtu vend destinimi dhe një përqindje më e vogël (26.1%) besojnë se Kosova ishte vend i origjinës së trafikimit të viktimave. Dëshmia nga terreni tregon se numri i viktimave kosovare është duke u rritur përderisa numri i viktimave të huaja është duke u zvogëluar. Duket se respondentët nuk janë plotësisht të informuar për natyrën e trafikimit në Kosovë.

Grafi 08. Sipas njohurisë që keni, çfarë është pozita e Kosovës në procesin e trafikimit njerëzor? A është vendi i origjinës – vendi në të cilin viktimat rekrutohen apo grabiten, vend transit apo vend destinues – në të cilin viktimat shfrytëzohen? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=459)



Pothuajse në përgjithësi, ata të cilët janë pyetur besojnë se trafikimi është prezent në Kosovë (shiko Grafi 09.). Një shumicë e madhe (64.5%) tregon se trafikimi është deri diku i përhapur, përderisa 33.6% besojnë se është shumë i përhapur.

Grafi 09. Sipas mendimit tuaj, sa është i përhapur trafikimi në Kosovë? A është shumë i përhapur, deri diku i përhapur, apo nuk është aspak i përhapur? (N=459)




Megjithatë, opinionet e respondentëve dallojnë në mënyrë të rëndësishme në ndërrimin e fokusit të tyre në komunitetet lokale të tyre, respektivisht, qyteteve apo fshatrave ku ata jetojnë. (shiko Grafi 10.)

31.4% të respondentëve besojnë se komunitetet e tyre lokale nuk janë të afektuar nga ky problem. Pak më shumë se gjysma e respondentëve (54%) besojnë se trafikimi është deri diku i përhapur, përderisa 7.8% besojnë se trafikimi është shumë i përhapur në komunitetet e tyre lokale. Duket se vendi rezidencial i respondentëve ndikon në mënyrën se si ata/ato e perceptojnë problemin e trafikimit. Një përqindje signifikante më e lartë e respondentëve nga vendet rurale (41.4%) besojnë


se trafikimi nuk është fare i përhapur në komunitetet e tyre në krahasim me vendet urbane me përqindje (26.2%).

Grafi 10. Sipas mendimit tuaj, sa është i përhapur trafikimi në komunitetin (fshatin, qytetin) tuaj? A është shumë i përhapur, deri diku i përhapur, apo nuk është aspak i përhapur? (N=459)



Pasi që shumica e respondentëve kanë qenë të vetëdijshëm për praninë e problemit, nuk është befasuese se ata janë të brengosur për këtë ceshtje. Pothuajse tri të katërtat e respondentëve (74.2%) kanë thënë se janë shumë të brengosur për përhapjen e trafikimit në Kosovë (shiko Grafi 11.), përderisa 20.6% të tjerë janë deri diku të brengosur.


Grafi 11. Sa jeni të brengosur me praninë e trafikimit njerëzor në Kosovë? A jeni shumë të brengosur, deri diku të brengosur, apo aspak nuk jeni të brengosur? (N=500)



Përgjegjësia për problemin dhe për parandalim

Opinionet e respondentëve janë fuqimisht të ndara në lidhje me çështjen se kush është përgjegjës për nivelin e trafikimit në Kosovë (shiko Grafi 12.). Pak më pak se një e treta e respondentëve (29.6%) i fajësojnë trafikantët, respektivisht kriminelët e përshtirë. Përafërsisht një në katër respondentë (27%) fajësojnë autoritetet për shkak se ata nuk janë duke bërë mjaft për ta parandaluar trafikimin, përdërisa 18.6% ia kanë hedhur fajin në mënyrë direkt policisë. (8.4%) të autoriteteve dhe (2.4%) të policisë janë të përshtirë në trafikim dhe janë përgjegjës për prezencën e tij në Kosovë.


Grafi 12. Kush mendoni se është përgjegjës për prezencën dhe përhapjen e trafikimit njerëzor në Kosovë? Nga këta që i përmendët, kush mendoni se është më së shumti përgjegjës për prezencën dhe përhapjen e trafikimit njerëzor në Kosovë? (Përgjigje e shumfisthtë) (N=500)



Me rastin e diskutimit të luftën kundër trafikimit, respondentët kanë theksuar se roli i policisë dhe autoriteteve (shiko Grafi 13.). Më shumë se 40% të respondentëve besojnë se policia duhet të


përkujdeset për problemin e trafikimit dhe të luftojë kundër tij, përderisa 38.4% të respondentëve ja mveshin këtë përgjegjësi qeverisë së Kosovës.

Grafi 13. Kush mendoni se duhet të kujdeset dhe të luftojë problemin e trafikimit njerëzor? (N=500)



Informimi i qytetarëve për trafikimin e qenieve njerëzore është gjithsesi një hap i rëndësishëm në parandalimin e tij. Prandaj, Prism i ka pyetur respondentët nëse mjaft informacione lidhur më problemin ofrohen publikisht. Tre nga pesë respondentë (60.4%) përgjigjen me jo (shiko Grafi 14.).


Grafi 14. Sipas mendimit tuaj, a ofrohen informata të mjaftueshme në publik për trafikimin e qenieve njerëzore? (N=500)



Angazhimi personal në luftim

Respodentët gjithashtu janë pyetur të mendojnë se çka do të bënin në rast se janë dëshmitar apo nëse pranojnë informacione në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Këtu Prism ka dashur të dijë nëse respodentët do ta ndanin informatën e tillë me të tjerët dhe nëse ata do të kontribuonin në luftën kundër trafikimit. Shumica dërmuese (shiko Grafi 15.) e respodentëve (92.8%) deklarojnë se ata do ta ndanin informatën me të tjerët.


Grafi 15. Nëse jeni dëshmitar i trafikimit njerëzor apo keni ndonjë informatë për të, a do ta ndanit këtë njohuri me dikë tjetër? (N=500)



≡ Po ■ Jo ■ Nuk e di/Refuzon të përgjigjet

Në pyetjen vijuese, respodentët kosovar (shiko Grafi 16.) në shumicën dërmuese të rasteve kanë konfirmuar se do të informonin policinë po që se do të kishin informacion lidhur me trafikimin. Më shumë se një e treta (34.5%) do të kontaktonin ndonjë organizatë joqeveritare ndërkombëtare apo vendore. Rreth një e pesta (20.7%) do të ndanin informacionin me KFOR-in, përderisa 16.2% do të drejtoheshin tek autoritetet lokale (komunale). Rreth një në dhjetë respodentë (12.3%) do të përdornin linjën telefonike falas të ndihmës. Respodentët të cilët nuk janë shprehur të jenë të gatshëm të ndanin informacionin lidhur me trafikimin zakonisht kanë shprehur frikën për sigurinë e tyre dhe të personave rreth tyre.


Grafi 16. Kë do ta kishit lajmëruar/informuar për një rast të trafikimit njerëzor? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=464)



Reintegrimi social dhe ndihma të shpëtuarve

A mund viktimat e shpëtuar të rehabilitohen dhe reintegrohen në familjet dhe bashkësitë e tyre, apo mund t'ju ofrohet zgjidhje tjetër nëse ato nuk mund të kthehen në shtëpitë e mëhershme? Në proces të reintegrimit social, viktimat qartazi kanë nevojë për përkrahje të institucioneve dhe profesionistëve por po ashtu kanë nevojë për përkrahje të familjes së tyre dhe të komunitetit të gjerë. Në këtë kontekst, Prism ka pyetur respondentët nëse reintegrimi i viktimave të shpëtuar do të ishte i mundur (*shiko Grafi 17*). Tre nga katër respondentët kosovar (75.4%) janë përgjigjur pozitivisht, përderisa një në dhjetë (9.8%) janë deklaruar negativisht.


Grafi 17. A mund të pranohen viktimat e trafikimit përsëri në familjet e tyre dhe në komunitet?
(N=500)



■ Po ■ Jo ■ Nuk e di/Refuzon të përgjigjet

Që të çoj deri në fund, Prism ka pyetur se kush mund t'ju ndihmoj viktimave të shpëtuar në proces të reintegrimit të tyre social. Përgjigjet e respondentëve kanë qenë të ndryshme (*shiko Grafi 18*). Gjashtë nga dhjetë (62.1%) besojnë se qeveria do të duhej të ndihmoj viktimat në reintegrimin social. Një përqindje diçka më e ulët (58.4%) besojnë se policia do të duhej të jetë përgjegjëse për këtë, përderisa 40.5% kanë thënë se kjo do të duhej të ishte përgjegjësi e Qendrave për Punë Sociale.


Grafi 18. Kush mendoni se duhet t'i ndihmojë viktimat e trafikimit njerëzor (Përgjigje e shumëfishtë)
(N=377)



Opinionet e respondentëve lidhur me formën e ndihmës që i nevojitet viktimave të trafikimit në reintegrimin social kanë qenë mjaft të ndara (*shiko Grafi 19*). Rreth çerekut të respondentëve

(24.6%) besojnë se viktimat kanë nevojë për ndihmë psiko-sociale, këshillim dhe rehabilitim. Diçka më pak se çereku i respondentëve (23%) besojnë se viktimat e trafikimit së pari kanë nevojë për akomodim të sigurt dhe ushqim, përdërisa 19.2% të tyre kanë thënë se viktimat kanë nevojë për mbrojtje të identitetit. Një në dhjetë (10.6%) janë fokusuar në rolin e familjes në këtë proces, duke theksuar rolin vendimtar të terapistit familjar.

Grafi 19. Sipas mendimit tuaj, cila formë e përkrahjes do të ishte ndihmesa më e madhe viktimave të trafikimit në tentativën e tyre për reintegrim social?? (N=500)



7. Të gjeturat – Sondazhi me grupin më të cenueshëm (Vajza të moshës 14 deri 18 vjeçare)

Përshkrimi i mostrës

Bazuar në profilin e viktimave vendore të trafikimit, Prism ka zhvilluar mostrën vetëm për vajza të reja duke besuar se ato janë grupi më i cenueshëm për trafikimin e qenieve njerëzore. Në harmoni me planin e mostrës për këtë sondazh, 300 pyetësorë janë kryer me vajza të moshës 14 deri 18 vjeç (shiko Tabelën 08.). Mostra ka qenë pak a shumë e balancuar me numrin e responentëve për secilën vit të kësaj moshe. Arsimimi i responentëve ka qenë konsistent me moshën e tyre, kështu që më shumë se gjysma e tyre kanë përfunduar shkollën fillore (54.3%) dhe kanë qenë duke vijuar shkollën e mesme (21.7%). Një përqindje më e vogël e responentëve ka përfunduar shkollën e mesme (2.7%) dhe kanë qenë duke vijuar fakultetin (1%).

Tabela 08. Përshkrimi i mostrës

		Frekuenca	Përqindja
MOSHA	14 vjeçare	43	14.3%
	15 vjeçare	58	19.3%
	16 vjeçare	60	20.0%
	17 vjeçare	68	22.7%
	18 vjeçare	71	23.7%
ARSIMIMI⁵	Nuk e ka përfunduar shkollën fillore	61	20.3%
	Përfunduar shkollën fillore	163	54.3%
	Vijuar shkollën e mesme	65	21.7%
	Përfunduar shkollën e mesme	8	2.7%
	Vijuar universitetin	3	1.0%
GRUPI ETNIK	Shqiptar	268	89.3%
	Serb	28	9.3%
	Rom	3	1.0%
	Tjetër	1	0.3%

⁵ Shiko Tabelën 09. për më shumë detale lidhur me arsimimin e vajzave të anketuara

Tabela 09. Arsimimi

ARSIMIMI	MOSHA									
	14		15		16		17		18	
	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%
Nuk e ka përfunduar shkollën fillore	28	65.1	21	36.2	2	3.3	3	4.4	7	9.9
Përfunduar shkollën fillore	14	32.6	29	50.0	43	71.7	51	75.0	26	36.6
Vijon shkollën e mesme	1	2.3	8	13.8	14	23.3	12	17.6	30	42.3
Përfunduar shkollën e mesme	0	0.0	0	0.0	1	1.7	0	0.0	7	9.9
Vijon studimet	0	0.0	0	0.0	0	0.0	2	2.9	1	1.4
TOTAL	43	100.0	58	100.0	60	100.0	68	100.0	71	100.0

Plani i mostrës po ashtu ka përcjellur që të përzgjedh lokacionet ku do të kryhet anketimi ashtu që 90% të anketave të kryhen në zonat me shumicë shqiptare dhe tjetra që mbet në zonat me shumicë serbe (*shiko Tabelën 10.*). Gjysma e respondentëve kanë jetuar në viset urbane dhe gjysma tjetër në viset rurale të Kosovës.

Shumë respondentë kanë përshkruar situatën ekonomike të familjes së tyre si të pafavorshme. Përdërisa një e treta (33%) të vajzave të reja besojnë se familja e tyre është e sigurt dhe një shtojcë tjetër prej 8% thonë se kanë fonde për argëtim dhe udhëtim, gati 20% kanë raportuar se nuk janë në gjendje të sigurojnë ushqim dhe strehim të rregullt, 22.7% deklaruan se kanë mjaft të holla të paguajnë për ushqim dhe strehim, dhe 15.7% kanë deklaruar se kanë vështirësi të paguajnë të gjitha faturat.


Tabela 10. Përshkrimi i mostrës

	Frekuenca	Përqindja	
ZONA	Shumicë shqiptare	270	90.0%
	Shumicë serbe	30	10.0%
RAJONI	KFOR Francez	70	23.3%
	KFOR Britanez	80	26.7%
	KFOR Amerikan	50	16.7%
	KFOR Gjerman	50	16.7%
	KFOR Italian	50	16.7%
LLOJI I VENDBANIMIT	Urban	150	50.0%
	Rural	150	50.0%
SITUATA SOCIO-EKONOMIKE	Ekonomikisht jemi mirë	100	33.3%
	Kemi burime për argëtim / udhëtime	24	8.0%
	Vështirë i paguajmë të gjitha faturat	47	15.7%
	Kemi të holla vetëm për ushqim dhe strehim	68	22.7%
	Nuk kemi të holla të mjaftueshme çdo muaj	57	19.0%
	Nuk di/Nuk dëshiron të përgjigjet	4	1.3%

Qasja në informata dhe besimi në institucione dhe organizata


Besimi në institucione dhe organizata i këtyre vajzave dhe mësimit për burimet në informata, mund të jenë të rëndësishme kryesore në luftimin e këtij problemi. Kjo nevojitet që të kanalizohet rrjedha e informatave lidhur me trafikimin drejt kësaj audience duke u bazuar në burimet e informatave dhe institucioneve të cilat ato kanë dëshirë t'i përdorin. Më shumë se gjysma (62.3%) (shiko Grafi 20.), të vajzave në sondazh përdorin mediat të informohen. Familjet po ashtu janë burim i rëndësishëm i informatave për çështjet e rëndësishme për vajzat e kësaj moshe (19.3%). Miqtë e moshës së njëjtë po ashtu janë burim i informatave (11.3%), përderisa vetëm një numër i vogël i respondentëve (6.3%) kanë raportuar se pranojnë informata për çështje të rëndësishme nga mësuesit dhe pedagogët në shkollë.

Grafi 20. Si informoheni me çështjet për të cilat ju besoni se janë të rëndësishme? (N=300)




Sa i përket besimit, vajzat e reja (62%) vendosin familjen më parë se institucionet dhe organizatat zyrtare (shiko Grafi 21.). Mirëpo, policia është vetëm disa pikë të përqindjeve më prapa (58.9%) dhe dallimi në mes të familjes dhe policisë nuk është statistikiisht i rëndësishëm. Përqindje të rëndësishme më e ulët (18%) i besojnë autoriteteve lokale, në fakt komunale.

Grafi 21. Cilave organizata apo institucione ju i besoni më së shumti? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=300)



Pasi që respondentët e pranojnë shumicën e informatave prej mediave, ata besojnë se programet televizive për të rinj janë kanali më i mirë i përcjelljes së porosive tek kjo audiencë (shiko Grafi 22.). Ky opinion ndahet nga më shumë se gjysma e respondentëve (60%) dhe 8% shtesë theksojnë se radio programet për të rinj do të mund të kryenin punë. Rreth 15% të respondentëve besojnë se informatat mund të shpërndahen nëpërmjet orëve të mësimi nëpër shkolla. Pasi që informatat prej mediave dhe në veçanti nga televizioni është mënyra më efikase që të arrihet deri tek kjo audiencë, përcjellja e porosisë do të duhet të adaptohet për këtë grup si në çështjen e përmbajtjes ashtu edhe të kohës së emetimit. Pasi që personat e kësaj moshe në mënyrë të vazhdueshme mbështeten në familjet e tyre, siç edhe është veçuar nëpërmjet këtij hulumtimi, po ashtu është e nevojshme që të ofrohen informata për trafikim edhe popullsisë së përgjithshme. Kampanjë gjithëpërfshirëse për informimin e qytetarëve të Kosovës, me fokus të veçantë tek grupet më të cenueshme, do të ngriste vetëdijen për këtë problem përvëlues.


Grafi 22. Nëse dikush (shembull ndonjë organizatë) dëshiron të përcjell informata tek vajzat e moshës tuaj, cila do të ishte mënyra më e mirë ta bëjë këtë? (N=300)



Njohuritë lidhur me termin “trafikimi i qenieve njerëzore”


Sikurse edhe me sondazhin e popullsisë së përgjithshme, shumica e vajzave të reja kanë dëgjuar për termin “trafikimi i qenieve njerëzore.” Duke marrë parasysh se kjo është bërë çështje publike, kjo edhe ka qenë e pritshme (shiko Grafi 23.).

Grafi 23. A keni dëgjuar ndonjëherë për termin “trafikim njerëzor”? (N=300)



Duke ju referuar mënyrave se si trafikantët e qenieve njerëzore i shfrytëzojnë viktimat e tyre, përgjigjet e vajzave të reja kanë qenë të ngjashme me ato të popullsisë së përgjithshme (*shiko Grafi 02. dhe Grafi 24.*). Rreth katër nga pesë respondentë (79.2%) kanë përmendur prostitucionin, në fakt, shfrytëzimin seksual. Më shumë se një e treta (35.6%) kanë pasur njohuri se viktimat e trafikimit përdoren, pos gjërave të tjera, edhe për marrjen ilegale të organeve me qëllim të transplantimit, përdërisa rreth një e pesta kanë qenë të vetëdijshme edhe për martesat me dhunë (19.3%), punësim me pagesë të ulët (19.3%) dhe kërkim të lëmshës në mënyrë të organizuar (18.2%). Një numër më i vogël i respondentëve ka përmendur forma tjera të shfrytëzimit.

Grafi 24. A e dini si i shfrytëzojnë trafikuesit e njerëzve viktimat e tyre – a mund të më jepni ndonjë shembull? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=283)



Sikurse me popullsinë e përgjithshme, jo shumë vajza kanë mundur të definojnë dallimin në mes të trafikimit dhe prostitucionit (*shiko Tabelën 11.*). Gati 45% të vajzave të anketuara nuk kanë qenë në gjendje apo kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje. Ato të cilat janë përgjigjur kanë ofruar përgjigje të ndryshme. Diçka më pak se çereku i respondentëve (23.7%) drejtë kanë besuar se prostitucioni është apo mund të jetë me vetëdëshirë, përdërisa trafikimi përfshin përdorimin e forcës (dhunës). Përgjigjet tjera më pak të hasura përfshijnë shpjegime tjera.


Tabela 11. Për fund, a mund të më tregoni me fjalë tuaja dallimin në mes të trafikimit dhe prostitucionit? (Pyetje e hapur) (N=300)

Përgjigjet	%
Trafikimi është me forcë (kidnapim), prostitucioni është/mund të jetë me vetëdëshirë	23.7
Nuk ka dallim (janë të ndërlidhura mes vete)	7.7
Trafikimi është shfrytëzim, prostitucioni është seks	4.0
Trafikimi është kur dikush shfrytëzon dikë tjetër për përfitime personale, prostitucioni është kur dikush e shet trupin e vet për pare	3.9
Trafikimi ndodh pa marrë parasysh moshës/gjinisë, prostitucioni ndodh vetëm me femra (me vetëdëshirë)	2.0
Ka mënyra të ndryshme për trafikim, prostitucioni është seks	1.7
Trafikimi nuk është përmes forcës, prostitucioni është me dhunë	1.7
Trafikimi shpien në prostitucion	1.3
Secili mund të jetë viktimë e trafikimit	1.0
Trafikimi bëhet për shkak të transplantimit të organeve, prostitucioni përfshin femra (seks)	0.7
Prostitucioni është kur femrat janë të keqtrajtuara seksualisht, trafikimi behët për arsye tjera	0.7
Trafikimi mund të bëhet në më shumë mënyra, prostitucioni është seks i paguar	0.7
Trafikimi nënkupton sjellje më të ashpër abuzuese	0.7
Personat e trafikuar janë të shtyre të bëjnë gjëra të ndryshme, siç është kërkimi i lëmoshës në rrugë, prostitucioni detyron dikë të punon në shtëpi publike	0.7
Trafikimi është transportimi ilegal, prostitucioni është seks	0.6
Tjetër	4.7
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	44.3

Viktimat e trafikuar – njohuritë dhe paragjykimet


Këto vajza të reja ndajnë shumë nga opinionet e shprehura nga popullsia e përgjithshme (shiko Grafi 03. dhe Grafi 25.). Për shembull, trafikimi i qenieve njerëzore besohet që më së shumti të afektoj femrat, në fakt, femrat dhe vajzat e reja. Gati gjysma e respondentëve (49.8%) besojnë se femrat janë viktimat më të shpeshta të trafikantëve përderisa 34.8% besojnë se janë vajzat e reja. Pak më shumë se një në dhjetë respondentë (12%) kanë shprehur bindjen se fëmijët janë viktimat më të shpeshta të trafikimit.

Grafi 25. Kush mendoni se janë më së shpeshti viktimat të trafikimit njerëzor? (N=300)




Vajzat e reja të anketuara besojnë se çdokush nuk është në rrezik të njëjtë të trafikohet. Për më tepër, disa grupe janë në rrezik më të madh të bëhet viktimë. Ky opinion është ndarë nga gati të gjithë (94.3%) të respondentëve (shiko Grafi 26.)

Grafi 26. A janë disa persona në rrezik më të madh që të trafikohen? (N=300)



Përgjigjet në pyetjen e cila shtrohet se cilat grupe janë në rrezik më të madh shpalosin se besohet që femrat janë në rrezik të veçantë. Shumica e respondentëve besojnë se vajzat e reja (48.4%), respektivisht femrat (47%) janë në rrezik më të madh. Vetëm 3.2% të respondentëve besojnë se fëmijët janë në rrezikun më të madh, përdërisa përqindje jo signifikante kanë përmendur djemtë e ri (shiko Grafi 27.).

Grafi 27. Kush mendoni se është në rrezikun më të madh? (N=283)



Pyetja në vijim është përdorur të identifikohen perceptimet e respondentëve lidhur me rrezikun (shiko Tabelën 12.). Në vijë me përgjigjet e mëhershme, shumica e vajzave të reja (84.3%) besojnë se femrat janë në rrezik më të madh se meshkujt (1.3%), përdërisa 14.3% besojnë se rreziku është i njëjtë për të gjithë. Fëmijët dhe të rinjtë (79.7%) po ashtu konsiderohen të jenë në rrezik më të madh se sa njerëzit e moshuar (3.7%). Megjithatë, 15% të respondentëve nuk besojnë se moshja është faktorë vendimtar.

Në vazhdim, shumica e respondentëve nuk besojnë se statusi ekonomik i personit ndikon në nivelin e rrezikut (46.3%). Mirëpo, diçka më pak se një e treta e vajzave të reja të anketuara (30.3%), besojnë se të varfrit janë në rrezik më të lartë të trafikohen, përdërisa 21% besojnë se personat më të pasur janë në rrezik më të madh. Më shumë se 40% besojnë se personat më pak të arsimuar janë në rrezik më të madh se sa ata që janë më shumë të arsimuar (10%), përdërisa 42% besojnë se rreziku është i njëjtë për të gjithë. Personat e painformuar besohet se janë në rrezik më të madh të trafikohen (59%) se sa ata të cilët kanë informatat e nevojshme (5.7%). Rreth çereku i të anketuarve (27%) besojnë se të qenurit i informuar nuk është faktor vendimtar që ndikon në nivelin e rrezikut. Më shumë se gjysma e respondentëve (58.7%) besojnë se rreziku është i njëjtë sikurse për ata që jetojnë në viset urbane, po ashtu edhe për ata në viset rurale. Gati gjysma e vajzave të reja të anketuara (46.3%) besojnë se inteligjenca nuk është faktor vendimtar që ndikon në rrezik dhe rreth një e treta e respondentëve (34.3%) besojnë se personat e pamoralshëm janë në rrezik më të madh, përdërisa gati gjysma e vajzave të anketuara besojnë se morali nuk është faktor kontribuues. Ka 15 pikë dallim në mes të përgjigjeve të vajzave të reja dhe të popullsisë së përgjithshme.

Gjatë krahasimit të këtyre rezultateve me ato të popullsisë së përgjithshme (shiko Tabelën 05.), Prism ka vërejtur disa ngjashmëri, mirëpo edhe dallime. Respondentët nga të dy sondazhet pak a shumë pajtohen se femrat dhe vajzat e reja janë në rrezik më të madh. Në anën tjetër, popullsia e

përgjithshme duket të ketë më shumë paragjyqime se sa vajzat e reja. Përfaqësuesit e popullsisë së përgjithshme besojnë se aftësitë e personit dhe morali janë faktor kontribuues në rrezikun e të qenurit i trafikuar, përderisa shumica e vajzave të reja besojnë se këta faktor nuk ndikojnë në këtë rrezik. Mirëpo, shumica signifikante e të dy audiencave pajtohen se të painformuarit janë në rrezik më të madh.

Tabela 12. Kush është në rrezikun më të madh që të trafikohet? (N=300)

Rrezik më të madh %		Rreziku është i njëjtë	ND/R	Rrezik më të madh %	
Femër	84,3	14,3	0,0	1,3	Mashkull
Fëmijët dhe të rinjtë	79,7	15,0	1,7	3,7	Personat e moshës së mesme dhe të vjetrit
Më të varfrit	30,3	46,3	2,3	21,0	Më të pasurit
Të paarsimuarit	41,0	42,0	6,7	10,3	Të arsimuarit
Të pamoralshmit	34,3	48,3	9,7	7,7	Të moralshmit
Më pak inteligjent	36,3	46,3	9,3	8,0	Më shumë inteligjent
Të painformuar	59,0	27,0	8,3	5,7	Të informuar
Rural	20,7	58,7	5,0	15,7	Urban

Tjetër, Prism ka pyetur vajzat e reja të shprehin opinionin e tyre lidhur me deklaratat e ndryshme të bëra lidhur me viktimat e trafikimit. Rreth një në pesë respondentë (22.4%) pajtohen se viktimat e trafikimit mund të arratisen po që se ato njëmend dëshirojnë (shiko Tabelën 13.). Kjo përqindje është 14 pikë më e ulët se sa ajo e popullsisë së përgjithshme (shiko Tabelën 06.). Ngjashëm, diçka më pak se çereku i vajzave të reja (23.6%) pajtohen se viktimat e trafikimit kanë njohuri se në çfarë janë duke u futur, rreth shtatë pikë më pak se popullsia e përgjithshme (dallimi është statistikisht signifikant në nivelin 5%). Më shumë se gjysma e respondentëve vajza (64.3%) nuk pajtohen me deklaratën se prostitutat janë të pamoralshme. Megjithatë, është brengosëse se edhe kur janë pyetur në një mënyrë tjetër, 38.6% të respondentëve të rinj besojnë se edhe nëse dikush është i shtyre me dhunë në prostitucion, ata janë të pamoralshëm.

Në anën tjetër, respondentët në të dy sondazhet pajtohen se personat që shfrytëzojnë shërbimet e prostitutave në Kosovë janë të pamoralshëm. Mirëpo, në mesin e vajzave të reja, 22.7% nuk kanë qenë në gjendje të përgjigjen. Kjo më e mundura është për shkak të mungesës së eksperiencës dhe njohurive. Më shumë se dy të pestat (42.4%) besojnë se vajzat e trafikuar duhet të jenë paksa të marra të ngatërrohen (shoqërohen) me kodosh (makro). Konkludim i arsyeshëm i më shumë se gjysmës së respondentëve (63.6%) ka qenë se vajzat trafikohen për shkak se ato kanë nevojë për të holla. Përgjegjësia për trafikim i përcaktohet trafikantëve dhe ata besohet se kryejnë veprë kriminale. Në fund, Prism ka pyetur vajzat të vlerësojnë nëse ato janë në rrezik dhe 62.2% pajtohen se atyre nuk mund t'ju ndodh të jenë viktimat e trafikimit përderisa çereku i tyre nuk pajtohen me këtë pohim.

Tabela 13. Do t'ju lexoj një listë me pohime dhe dëshiroj që ju të më tregoni nëse pajtoheni fuqimisht, deri diku pajtoheni, deri diku nuk pajtoheni apo fuqimisht nuk pajtoheni me secilën nga deklaratat që do t'ju lexoj. (N=300)

Pohimet/përgjigjet	Fuqimisht pajtohet	Deri diku pajtohet	Deri diku nuk pajtohet	Fuqimisht nuk pajtohet	ND/R
Njerëzit të cilët përfshihen në trafikim mund lehtë të ikin nëse me të vërtetë dëshirojnë.	4,7	17,7	30,7	38,3	8,7
Viktimat e trafikimit kanë njohuri se në çfarë janë duke e futur veten.	3,3	20,3	32,7	36,7	7,0
Vajzat të cilat trafikohen janë të pamoralshme sepse ato janë bërë prostituta (punëtore të seksit komercial).	11,7	14,0	29,3	35,0	10,0
Viktimat e trafikimit meritojnë ndihmën e qeverisë.	68,0	18,7	5,7	4,0	3,7
Vajzat të cilat janë të trafikuar duhet të jenë paksa të marra të shoqërohen me makro (kodosh, rrufjan).	21,7	20,7	19,3	11,7	26,7
Vajzat të cilat janë të trafikuar përfshihen në trafikim sepse atyre ju nevojiten të hollat dhe nuk kanë mënyrë tjetër si t'i fitojnë.	14,3	49,3	14,0	12,7	9,7
Vajzat të cilat janë të trafikuar janë viktima; është faji i trafikantëve të cilët kryejnë krim.	59,0	14,3	5,3	9,0	12,3
Përdorimi i shërbimeve seksuale nga punëtorët e seksit është i pamoralshëm.	43,3	20,0	6,3	7,7	22,7
Edhe pse dikush mund të jetë e shtyrë në prostitucion, ajo (punëtorja e seksit) është e pamoralshme	19,3	19,3	11,0	25,3	25,0
Unë kurrë nuk do të mund të isha i/e trafikuar.	43,1	18,1	9,0	16,4	13,4

Sikurse me popullsinë e përgjithshme, shumica e respondentëve (50.7%) nuk kanë njohuri se si ta njohin viktimën e trafikimit. Prej atyre që kanë dhënë ndonjë përgjigje, përgjigja më e shpeshtë (17%) ka qenë se mund të vërehet sjellja e tyre e çuditshme. Mungesa e personit i cili mund të jetë viktimë potenciale po ashtu ka qenë një shenjë tjetër (përmendur nga 6.3% të respondentëve); përderisa 5.3% të respondentëve besojnë se viktimat e trafikimit mund të njihen vetëm nëse ai/ajo ofron informacionin për situatën e tij/saj apo nëse një informatë e tillë pranohet nga ndonjë burim tjetër (shiko Tabela 14.).


Tabela 14. Si mund ta dimë nëse një person është viktimë e trafikimit? (Pyetje e hapur) (N=300)

Përgjigjet	%
Sjellja e çuditshme	17.0
Nëse mungon për një kohë, nuk tregojnë se ku janë	6.3
Nëse më tregon viktima/marrë vesh prej ndonjë burimi tjetër	5.3
Dukja e tyre	4.3
Është introverte, rri vetëm	2.0
Shenja të abuzimit	2.0
Dallon nga të tjerët	1.7
Duket e lodhur	1.7
Nëse nuk e njohim nga më parë	1.7
Nuk rri me shoqëri të njëjtë sikurse më herët	0.7
Mënyra se si flasin	0.7
Nëse është e traumatizuar	0.7
Mund ta njihni vetëm nëse e shihni	0.7
Nuk mund të orientohet, nuk e flet gjuhën	0.7
Tjetër	4.0
Nuk e di/Refuzon të përgjigjet	50.7

Trafikimi i qenieve njerëzore në Kosovë


Sikurse me popullsinë e përgjithshme, shumica dërrmuese (91.7%) e respondentëve femra (shiko Grafi 05. dhe Grafi 28.), besojnë se trafikimi është prezent në vend.

Grafi 28. Sipas mendimit tuaj, a është problemi i trafikimit njerëzor prezent në Kosovë? (N=300)




Shumica e respondentëve kanë dëgjuar për problemin (*shiko Grafi 29.*) nga programet televizive të cilat i kanë parë (93.1%), përderisa burimet tjera përfshijnë gazetatat dhe revistat (26%), radio programet (22%), institucionet edukative përmes mësimdhënësve dhe punonjësve të tjerë arsimor (21.2%), miqtë dhe farefisi (12.5%). Numri i respondentëve që njohin dikë që përdor shërbimet e viktimave të trafikimit është deri diku më i lartë tek vajzat e reja (5.1%) se sa tek popullsia e përgjithshme (1.5%) (dallimi është statistikisht signifikant në nivelin 1%). Mirëpo, kjo mund të shpjegohet nga ngatërrimi i përgjithshëm në mes të trafikimit dhe prostitucionit.

Grafi 29. Në çfarë mënyre ke dëgjuar për problemin e trafikimit njerëzor në Kosovë? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=275)




Në ofrimin e përgjigjes në pyetjen lidhur me pozitën e Kosovës në trafikimin e qenieve njerëzore, vajzat e reja kanë përqindje të ngjashme të perceptimit me atë të popullsisë së përgjithshme (*shiko Grafi 08. dhe Grafi 30.*). Diçka më pak se tre të katërtat e respondentëve besojnë se Kosova ka qenë vend i transitit dhe rreth çereku i respondentëve besojnë se është vend i destinacionit. Mirëpo, vetëm 20% të respondentëve besojnë se Kosova është vend i origjinës. Sikurse popullsia e përgjithshme, shumica e kosovarëve nuk e perceptojnë se femrat/vajzat lokale trafikohen.

Grafi 30. Sipas njohurisë që keni, çfarë është pozita e Kosovës në procesin e trafikimit njerëzor? A është vendi i origjinës – vendi në të cilin viktimat rekrutohen apo grabiten, vend transit apo vend destinues – në të cilin viktimat shfrytëzohen? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=275)




Vajzat e reja të anketuara pajtohen se ky problem është prezent në Kosovë (*shiko Grafi 31.*). Më shumë se gjysma e respondentëve (53.7%) besojnë se problemi është deri diku i përhapur përdherisa diçka më shumë se një e treta (38%) ofrojnë vlerësim më të errët duke pohuar se trafikimi është shumë i përhapur. Nëse këto rezultate krahasohen me ato të popullsisë së përgjithshme, mund të vërejmë se përqindje deri diku më e ulët e respondentëve nga grupi i rrezikuar (91.7%) sesa nga popullsia e përgjithshme (98.1%) besojnë se trafikimi është pak a shumë i përhapur në Kosovë (*shiko Grafi 09.*). Pasi që dallimet e cekura janë statistikiisht signifikante, mund të konkludohet se vajzat e reja vlerësojnë se trafikimi është më pak i shprehur (prezent).

Grafi 31. Sipas mendimit tuaj, sa është i përhapur trafikimi në Kosovë. A është shumë i përhapur, deri diku i përhapur, apo aspak nuk është i përhapur? (N=300)




Lidhur me perceptimin e prezencës së trafikimit në bashkësitë lokale (*shiko Grafi 32.*), në fakt, në qytete dhe fshatra ku ato jetojnë, diçka më pak se një në pesë (18%) nuk kanë njohuri apo kanë refuzuar të përgjigjen, përdherisa diçka më pak se gjysma (47.3%) besojnë se trafikimi është deri diku apo shumë i përhapur. Krahasuar me rezultatet e fituara nga popullsia e përgjithshme, këto rezultate janë të ngjashme. Siç ka qenë rasti edhe me popullsinë e përgjithshme (*shiko Grafi 10.*), përqindje signifikante më e lartë e respondentëve nga viset rurale (48%) se sa ato urbane (22.3) të Kosovës besojnë se bashkësitë e tyre lokale janë të paprekura nga ky problem.

Grafi 32. Sipas mendimit tuaj, sa është i përhapur trafikimi në komunitetin (fshatin, qytetin) tuaj? A është shumë i përhapur, deri diku i përhapur, apo aspak nuk është i përhapur? (N=300)




Vajzat e reja të anketuara janë të vetëdijshme për problemin e trafikimit në Kosovë. Shumica kanë dëgjuar për termin dhe tregojnë nivel relativisht të lartë të njohurive lidhur me mënyrat se si trafikantët i shfrytëzojnë viktimat. Pasi që respondentët besojnë se vajzat e reja janë në rrezik më të lartë, nuk është befasuese se ato janë të brengosura me përhapjen e këtij problemi në Kosovë (shiko Graf 33.). Diçka më pak se një në tre respondentë (30.7%) janë deri diku të brengosur, përdërisa 64% janë shumë të brengosur.

Graf 33. Sa jeni ju të brengosur me praninë e trafikimit njerëzor në Kosovë? A jeni shumë të brengosur, deri diku të brengosur apo aspak nuk jeni të brengosur? (N=300)



Kur është kërkuar të shpjegojnë arsyet dhe faktorët që kanë shpie në shfaqjen e trafikimit në Kosovë (shiko Graf 34.), shumica (56.3%) kanë atribuuar situatën e pavolitshme socio-ekonomike. Gati një në tre (32.3%) besojnë se ka qenë dëshira e personave të fitojnë shpejtë para. Rreth një të katërtat (26.2%) e respondentëve kanë atribuuar shfaqjes së trafikimit të qenieve njerëzore prezencës ndërkombëtare në Kosovë. Veç kësaj, respondentët kanë përmendur ekzistimin e krimit të organizuar (25.4%), prevalencës së imoralitetit (24.2%) dhe fazës së transicionit (23.4%) me të cilin ballafaqohet vendi si arsye të shfaqjes së trafikimit.


Grafi 34. Sipas mendimit tuaj, cilat janë arsytet dhe faktorët që kanë sjellë trafikimin në Kosovë?
(Përgjigje e shumëfishtë) (N=275)



Përgjegjësit për përhapjen dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore


Lidhur me pyetjen se kush është përgjegjës për prezencën dhe nivelin e trafikimit në Kosovë, asnjë nga përgjigjet e sugjeruara nuk ka fituar shumicën në përgjigjet e vajzave të anketuara. Diçka më shumë se çereku fajësojnë trafikantët, në fakt, kriminelët që janë të përfshirë në trafikim. Rreth një në pesë respondentë i kanë atribuar problemin policisë (22%) dhe autoriteteve (21.7%), të cilët nuk janë duke bërë mjaft që ta parandalojnë këtë fenomen (*shiko Grafi 35*). Më pak se një në dhjetë respondentë besojnë se klientët janë përgjegjës. Edhe pse rezultatet e fituara nga vajzat e reja janë të ngjashme me ato të popullsisë së përgjithshme (*shiko Grafi 12*), këta ta fundit besojnë se autoritetet luajnë rol me signifikant se sa policia.

Grafi 35. Kush mendoni se është përgjegjës për prezencën dhe përhapjen e trafikimit njerëzor në Kosovë? Nga këta që i përmendët, kush mendoni se është më së shumti përgjegjës për prezencën dhe përhapjen e trafikimit njerëzor në Kosovë? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=300)




Sipas vajzave të anketuara, policia duhet të marrë përgjegjësinë të luftoj trafikimin e qenieve njerëzore; opinion i ngjashëm edhe nga diçka më pak se gjysma e respondentëve të tjerë (46%). Diçka më shumë se një në tre respondentë (36.7%) besojnë se kjo do të duhej të ishte përgjegjësi e qeverisë (shiko Grafi 36.).

Grafi 36. Kush mendoni se duhet të kujdeset dhe të luftojë kundër problemit të trafikimit njerëzor? (N=300)



Kur janë pyetur nëse janë të mjaftueshme informatat që janë në dispozicion lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, grupi më i cenueshëm ka shfaqur mendim konfliktuoz (shiko Grafi 37.). Rreth një në dy respondentë kanë shfaqur besimin se informatat që janë në dispozicion janë të mjaftueshme, përderisa 43% besojnë se më shumë informata do të duhet të ofrohet lidhur me këtë çështje. Respondentët nga popullsia e përgjithshme (shiko Grafi 14.) kanë opinion deri diku më negativ lidhur me qashtësinë e informatave për trafikimin e qenieve njerëzore në Kosovë.

Grafi 37. Sipas mendimit tuaj, a ofrohen informata të mjaftueshme në publik për trafikimin e qenieve njerëzore? (N=300)




≡ Po ☒ Jo ■ Nuk e di/Refuzon të përgjigjet

Angazhimi personal në luftimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Kur janë pyetur lidhur me gatishmërinë e tyre që personalisht të përfshihen në luftë kundër trafikimit, përgjigjet e vazave të reja kanë qenë të ngjashme me mostrën e popullsisë së përgjithshme (*shiko Grafi 15. dhe Grafi 38.*). Nëse do të vërenin apo do të kishin informacion lidhur me trafikim, gati të gjitha vajzat (97.7%) do ta ndanin këtë njohuri me të tjerët.


Grafi 38. Nëse jeni dëshmitar i trafikimit njerëzor apo keni ndonjë informatë për të, a do të ndanit këtë njohuri me dikë tjetër? (N=300)



■ Po ■ Jo ■ Nuk di/Refuzon të përgjigjet

Kur janë pyetur se më kë do të ndanin këto informata të rëndësishme, shumica dërrmuese (86%) do të drejtoheshin tek policia sepse ata besojnë se ata do të duhej të luftonin trafikimin (*shiko Grafi 39.*). Duke marrë parasysh moshën e këtij grupi të cenueshëm, nuk është befasues se diçka më pak se një në tre respondentë (31.7%) do të ndanin këto informata me anëtarët e familjes. Një në katër respondentë do të drejtohej tek organizatat joqeveritare ndërkombëtare apo të vendit dhe përqindje më e vogël e respondentëve do të drejtohej tek autoritetet lokale (komunale) (13.7%), KFOR-it (13.3%), etj.


Grafi 39. Kë do ta kishit informuar/lajmëruar për një rast të trafikimit njerëzor? (Përgjigje e shumëfishtë) (N=293)



Viktimat e mëhershme të trafikimit – reintegrimit social dhe ndihma

Pyetjet në vijim janë parashtruar të shqyrtoj njohuritë dhe opinionet e respondentëve lidhur me reintegrimit social të viktimave të mëhershme të trafikimit. Shumica e vajzave (95.3%) janë pajtuar se viktimat e trafikimit do të duhet të ndihmoheshin në reintegrimit social dhe në familje (shiko Graf 40.)


Graf 40. A kanë nevojë viktimat e trafikimit ndihmë që të reintegrohen në familjet e tyre dhe komunitet? (N=300)



≡ Po ■ Jo ■ Nuk e di/Refuzon të përgjigjet


Kur janë pyetur lidhur me rolin e bashkësisë – përfshirë edhe familjes, komunitetit më të gjerë, përgjegjësitë e organizatave dhe institucioneve – në reintegrimit social të viktimës, shumica e vajzave të anketuara kanë theksuar rëndësinë e përkrahjes së familjes (58.1%), sikurse edhe të rolit të qeverisë (46.9%). Një në katër vajza kanë shfaqur besimin se autoritetet lokale do të duheshin të luanin rol të rëndësishëm, përderisa roli i të tjerëve në listë, të organizatave, institucioneve, dhe individëve të tjerë mendohet të jetë më pak i rëndësishëm (shiko Graf 41.).

Graf 41. Kush mendoni se duhet t'i ndihmojë viktimave të trafikimit njerëzor? (N=286)



Lidhur me formën e ndihmës që do të duhej ofruar, përgjigjet e dhëna janë mjaft të llojlojshme (shiko Grafi 42.). Nevoja të ofrohet ndihmë psiko-sociale, këshillim dhe rehabilitim është përmendur nga diçka më pak se një në tre respondentë (32.7%). Rreth çereku (24%) i respondentëve besojnë se viktimat kanë nevojë për ndihmë në mbrojtjen e identitetit të tyre, përderisa më rrallë janë shfaqur përgjigjet tjera.


Grafi 42. Sipas mendimit tuaj, cila formë e përkrahjes do të ishte ndihmesa më e madhe viktimave të trafikimit në tentativën e tyre për reintegrim social? (N=300)



Prirja për sjellje të rrezikshme

Pasi që është vërejtur se këto vajza të reja kanë qenë mjaft mirë të informuara lidhur me informatat kyçe për trafikim dhe janë të vetëdijshme se i takojnë grupit më të cenueshëm, Prism ka pyetur ato se si e shohin ato situatën. Në fakt, a besojnë ato nëse personalisht janë në rrezik (shiko Grafi 43.). Diçka më pak se çereku (23.3%) i respondentëve besojnë se nuk janë në rrezik, përderisa diçka më pak se gjysma e tyre (45%) besojnë se janë deri diku apo në rrezik të madh të trafikohen.

Grafi 43. A ndiheni se jeni në rrezik të trafikoheni? (N=300)



⊗ Po, në masë të madhe ⊖ Po, deri diku ⊘ Jo edhe aq ■ Aspak ▒ Nuk e di/Refuzon

Pasi që vajzat e anketuara janë të vetëdijshme për rrezikun, Prism ka pyetur për mënyrat se si ato mund ta mbrojnë veten (*shiko Tabelën 15*). Më shumë se çereku i respondentëve (29%) janë fokusuar në rëndësinë e ambientit dhe përzgjedhjes së shoqërisë.⁶ Diçka më pak se një në dhjetë respondentë (9.3%) kanë theksuar rëndësinë e policisë dhe të autoriteteve. Është me rëndësi të theksohet se 7.7% të respondentëve kanë pohuar se ato do të mbronin veten duke marrë më shumë informata lidhur me këtë problem.


Tabela 15. A mund të më tregoni me fjalë tuaja se si mund të mbroheni nga trafikimi? (Përgjigje e hapur) (N=300)

Përgjigjet	%
Të mos afrohem/shoqërohem me të panjoftur (të zgjedhim shoqërinë)	29,0
Më shumë kontroll nga policia (qeveria)/informoj autoritetet	9,3
Nuk do të dilja jashtë vet, posaçërisht jo natën	7,7
Ofroj (marrë) më shumë informata lidhur me trafikimin	7,7
Të mos i besoj të panjofturve	7,0
Të mos shkoj në vende/nënshtrohem situatave të rrezikshme (ku përdoret droga, etj.)	4,3
Bisedoj (dëgjoj) prindërit më shpesh	2,3
Të jem më e kujdesshme (ndaj njerëzve që nuk i njoh)	1,7
Kërkoj ndihmë	1,0
Sille mirë	0,7
Tjetër	2,0
Nuk e di/Refuzoj të përgjigjem	22,3

Pasi që dëshira të gjejnë punësim dhe mjete financiare në ambient të pafavorshëm ekonomik mund t'i sjell vajzat e reja në situata në të cilat do të rritet rreziku nga trafikimi, Prism ka dashur të kuptoj se si këto vajza do të sillëshin në situata të tilla dhe sa janë të vetëdijshme për rreziqet potenciale. Së pari kemi pyetur për burimet primare të hyrave personale (*shiko Grafi 44*). Duke konsideruar moshën e respondentëve, nuk është befasuese se anëtarët tjerë të familjes janë burim primar i të hyrave për gati të gjitha ato (94.7%).


⁶ Një numër i viktimave të mëhershme kanë treguar se njerëzve të cilët ju kanë besuar i kanë shpër në viktimizim.

Grafik 44. Cili është burimi primar i të hyrave personale? (N=300)



Tjetër, vajzat janë pyetur se ku do të kërkonin këshillë po që se do t'ju ofrohej ndonjë punë. Është pozitive se shumica dërrmuese e vajzave të anketuara (90.7%) do t'i drejtoheshin anëtarëve të ngushtë të familjes për këshillë (shiko Grafik 45).


Grafik 45. Nëse dikush do të ofroj ndonjë punë, kë do ta pyesni për këshillë para se të vendosni a ta pranoni punën apo jo? (N=300)



Prej vajzave pastaj është kërkuar të imagjinojnë se janë duke kërkuar punë dhe për mënyrat se si do të kërkonin punë (shiko Grafik 46.). Më shumë se gjysma e respondentëve (56.7%) do t'i drejtoheshin miqve apo familjes për ndihmë. Është shqetësuese se numër i madh i vajzave të anketuara kanë theksuar se do të mbështeteshin në shpallje për punësim të cilat mund të përfshijnë edhe oferta sfiduese të tërheqin vajzat e reja. Përderisa 17.7% të respondentëve pohojnë se do të aplikojnë në shpallje të "sigurta" pune, ku ato mund të konfirmojnë ofertën e bërë nga punëdhënësi i besueshëm. Mirëpo, 16.7% të respondentëve kanë pohuar se do të aplikojnë në të gjitha shpalljet

për punë derisa do të gjenin punë. Përderisa sjellja e tillë mund të mos rezultojë patjetër në situatë trafikimi, dukshëm rrit rrezikun. Kampanja për informim grupit të ceneshëm lidhur me rreziqet nga trafikimi i qenieve njerëzore do të duhet të përqendrohet veçanërisht në mënyrat se si trafikantët tërheqin viktimat e tyre. Vajzat e reja do të duhet të informoheshin për rreziqet, si dhe për mënyrat se si të sillen në raste të tilla, dhe ku të kërkojnë ndihmë.

Grafi 46. Nëse do të duheshe të kërkoje punë apo ndryshoje punën e tanishme, si do të fillonit kërkimin? (N=300)



Si vazhdim i pyetjes së mëhershme, vajzat janë pyetur të parafytyrojnë se gjenden në situata të ndryshme dhe për reagimet e tyre (shiko Tabelën 16.). Disa situata tipike me anë të cilave trafikantët përdorin të joshin vajzat e reja janë të përshkruara në këtë tabelë – ato përfshijnë punë atraktive, arsimim, dhe oferta për martesë. Është pozitive se shumica e vajzave nuk do të pranonin oferta të tilla. Mirëpo, nuk guxojmë të anashkalojmë përqindjen e vogël të vajzave të cilat më e mundura apo edhe pa hezitim do të pranonin një ofertë atraktive, posaçërisht ofertat për punë atraktive.

Tabela 16. Do t'ju lexoj një listë të pohimeve. Paramendoni se jeni në një situatë të tillë dhe më tregoni se si do të vepronit? (N=300)

Pohimet/përgjigjet	Do të pranoja pa hezituar	Më e mundura do të pranoja	Më e mundura nuk do të pranoja	Do ta refuzoja ofertën pa hezituar	ND/R
Një person që nuk e njihni aq mirë ju ofron një punë të mirë jashtë vendit apo në ndonjë qytet tjetër të Kosovës.	0,3	4,0	30,7	63,0	2,0
Një person që nuk e njihni aq mirë ju ofron një mundësi për arsimim jashtë vendit apo në ndonjë qytet tjetër të Kosovës.	0,7	3,3	27,0	65,7	3,3
Një mashkull që nuk e njihni aq mirë ju ofron martesë dhe jetë me të mirë jashtë vendit apo ndonjë qytet tjetër të Kosovës.	0,7	1,7	17,3	75,7	4,7

8. Të gjeturat – Intervistat me viktime të trafikimit, të shpëtuarat

Hulumtimi kualitativ ka përfshirë intervistat me dhjetë femra të cilat kanë qenë viktime të trafikimit. Të gjitha vajzat/femrat e intervistuarat janë kontaktuar nëpërmjet strehimoreve apo shtëpive të sigurtat të cilat i kanë dhënë asistencë viktimave. Duke i ndarë me ne tregimet e tyre të dhimbshme, ato kanë kontribuar në mënyrë signifikante në këtë hulumtim duke na ndihmuar për t'i kuptuar më mirë të dhënat kuantitative dhe temën e këtij hulumtimi në përgjithësi.

Demografia

Ne i kemi intervistuar vajzat/femrat e moshave të ndryshme, të reja prej moshës 15 vjeçare deri në moshën 35 vjeçare (*shiko Tabelën 17.*). Shumica e vajzave janë rritur në pjesët rurale të Kosovës dhe shpeshherë ato vijnë nga familje jostabile ku dhuna në familje ka qenë e pranishme. Ekonomitë familjare ku ato kanë jetuar para se të trafikohen kanë qenë të dobëta dhe në një numër të rasteve janë përkeqësuar njëjtë sikur konflikti në Kosovë. Gjysma e vajzave e kanë lënë shkollën para se ta përfundojnë madje shkollën fillore dhe nuk kanë pasur eksperiencë pune para se të trafikohen.

Tabela 17. Demografia – Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

		Numri i intervistave
MOSHA	Më të reja se 15 vjet	2
	15-20	3
	21-25	1
	26-30	1
	31-35	2
	36-30	1
LLOJI I VENDBANIMIT	Urban	3
	Rural	7
ARSIMIMI	Nuk e ka përfunduar shkollën fillore	5
	E ka përfunduar shkollën fillore	5
GRUPI ETNIK	Shqiptare nga Kosova	6
	Shqiptare nga Shqipëria	2
	Ruse	1
	Bullgare	1

Jeta para se të bëhen viktime të trafikimit

Responentët kanë kujtime të ndryshme të jetës së tyre para se të trafikohen. Vajzat më të reja duket të kenë kujtesë më të mirë se sa ato që janë më të vjetra por kjo mund të jetë shkak i moshës së tyre. Megjithatë, shumica e vajzave/femrave e kujtojnë jetën në kushte të vështira ekzistenciale shtëpiake, veçanërisht pas fillimit të luftës në Kosovë ku shumë njerëz kanë humbur shtëpitë e tyre.

Jeta ime më parë ishte e mirë, shumë e mirë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Situata ka qenë relativisht e qetë, unë kam punuar dhe jam kujdesur për familjen time. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 16 dhe 20 vjet)

Situata e përgjithshme në vendin tim ka qenë e vështirë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 26 dhe 30 vjet)

Pasi që na ka lënë babai dhe nëna ime është martuar me dike tjetër, jeta ime dhe e motrës time ka ndryshuar. Unë jam martuar kur kam qenë e re dhe e kam marrë motrën time në mënyrë që të kujdesem për të. Burri im na ka trajtuar shumë keq prandaj jam detyruar të ik. Kushtet e jetesës kanë qenë shumë të vështira. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 16 dhe 20 vjet)

Kushtet e jetesës para se të trafikohem kanë qenë shumë të mira. (Viktimë e trafikimit, Bullgare, moshë në mes të 36 dhe 40 vjet)

Shumica e vajzave para se të trafikohen kanë jetuar me familjet e tyre – të rejtat kanë jetuar me prindërit e tyre ndërsa të vjetrat, të martuarat, kanë jetuar me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre. Siç do të paraqitet në këtë raport, shumica e këtyre vajzave/femrave e kanë humbur kontaktin me familjet e tyre pasi që janë trafikuar.

Unë kam jetuar me babin tim, me njerikën time dhe pesë motra. Në fillim kemi jetuar në një shtëpi e cila i ka takuar një serbi, por pastaj e kemi ndërtuar një shtëpi të re dhe kushtet tona të jetesës kanë qenë shumë të mira. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Unë kam jetuar me babin tim, nënën time dhe tre vëllezër. Kushtet e jetës në shtëpi kanë qenë shumë të vështira. Kemi jetuar në një shtëpi të vjetër në fshat. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 16 dhe 20 vjet)

Ne kemi qenë katër anëtarë të familjes, nëna ime, dy vëllezërit e mi dhe unë. Prindërit e mi kanë qenë të ndarë. Pasi që jam martuar kemi qenë vetëm dy anëtarë, burri im dhe unë. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes të 31 dhe 35 vjet)

Para se të trafikohem, unë kam jetuar me burrin tim dhe me familjen e tij. Ne e kemi pasur një shtëpi nga dheu dhe dy dhoma të vogla, të pamobiluara. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 31 dhe 35 vjet)

Ne kemi pasur një apartament dhe kushtet e jetesës kanë qenë të mira. (Viktimë e trafikimit, Bullgare, moshë në mes të 36 dhe 40 vjet)

Ø **Kushtet sociale ekonomike**

Situata financiare në shumicën e ekonomive shtëpiake ka qenë e vështirë. Shumica e anëtarëve të familjes kanë qenë të papunësuar dhe kanë jetuar nëpër vise rurale, prej nga shumica e vajzave janë, dhe në përgjithësi këto familje kanë qenë shumë të varfra me shumë pak mundësi për të fituar çfarëdo të ardhure.

Situata jonë financiare, pasi që e kemi ndërtuar shtëpinë, ka qenë e mirë mirëpo nuk mund të them se kemi pasur mjaft para. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Situata jonë financiare ka qenë shumë e vështirë. Ne kurrë s'kemi pasur para. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 16 dhe 20 vjet)

Nuk kam pasur para dhe rrallë herë vëllezërit e mi më kanë dhënë ndonjë ndihmë për nevojat e mia. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 16 dhe 20 vjet)

Unë kam pasur fëmijëri të vështirë pasi që kemi jetuar në varfëri të skajshme. Ne kemi mbijetuar me ndihma sociale të cilat babai im i ka marrë pasi që ka pasur sëmundje mentale. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 26 dhe 30 vjet)

Situata jonë financiare ka qenë shumë e vështirë. Mund të them se ka qenë katastrofike. Ne kemi punuar tokën dhe mezi që ia kemi dalë të mbijetojmë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes të 21 dhe 25 vjet)

Ne kemi pasur situatë të vështirë financiare. Kushtet e jetesës në familje kanë qenë të vështira. Unë nuk kam pasur të ardhura dhe nuk kam pasur mundësi të blej asgjë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Duke i marrë parasysh rrethanat e tanishme socio-ekonomike në Kosovë dhe duke e konsideruar moshën e shumicës së intervistuarve, nuk është befasuese se shumica nuk kanë pasur eksperiencë të mëparshme pune. Respondentët kanë raportuar se mundësitë e punësimit për Kosovarët janë të limituara për të dy gjinitë.

Nuk e di nëse ka qenë vështirë për të gjithë njerëzit të punësohen, apo nëse ka pasur dallime në gjini sa i përket aspektit të punësimit. Unë kam qenë e re dhe nuk kam qenë e interesuar të punësohem, por mendoj se si për meshkuj ashtu edhe për femra ka qenë vështirë të gjendet punë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Nuk e di por mendoj se për të dy gjinitë ka qenë vështirë të punësohesh. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Situata për punësim ka qenë e njëjtë si për meshkuj ashtu edhe për femra. Ka pasur mundësi që dikush të punësohet por pagat kanë qenë shumë të ulëta. Gjithashtu, pagat janë dhënë me vonese të madhe. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Ka qenë shumë vështirë të punësohesh. Së paku kështu ka qenë në atë kohë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 26 dhe 30 vjet)

Nuk kam pasur mundësi punësimi pasi që kam jetuar në fshat. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Viktimizimi dhe jeta si viktimë

Ka mënyra të ndryshme që trafikantët e qenieve njerëzore i përdorin për t'i joshur viktimat e tyre. Një nga mënyrat është përmes ofrimit të mundësisë për punësim. Në përgjithësi besohet (*shiko Tabelën 14.*) se viktimave i qasen njerëzit të cilët ato nuk i njohin. Disa të mbijetuara tregojnë se ato janë trafikuar në këtë mënyrë pasi që i janë përgjigjur shpalljes për punë. Një e mbijetuar e pranon se ka qenë e vetëdijshme për rrezikun pasi që nuk ka pasur kurrfarë ideje se çfarë pune është duke e pranuar. Megjithatë, të mbijetuarat tjera tregojnë se trafikantët ju kanë qasur viktimave të tyre nëpërmes njerëzve që ato i kanë njohur. Fakti se vajzat i janë dorëzuar trafikantëve të qenieve njerëzore nga të afërmit e viktimave apo shoqet/shokët e tyre është tmerruese dhe diçka që nuk ka dalur në pah prej hulumtimit kuantitativ.

Pata filluar të kem probleme me burrin tim. Nuk kam qenë e punësuar dhe kam dashur të punoj. E kam pranuar punën jashtë vendit edhe pse nuk kam qenë e sigurt se çka do të punoja. E kam pranuar këtë punë për shkak të interesit financiar. Unë i siguroj të ardhurat për fëmijët e mi dhe familjen time. (Viktimë e trafikimit, Bullgare, moshë në mes 36 dhe 40 vjet)

Në një gazetë e kam parë shpalljen për punë. E kam thirrur me telefon këtë vajzë dhe ajo më ka thënë se është një grup i vajzave të cilat janë duke pritur për të shkuar në Itali. Ata na kanë treguar se do të na dërgojnë në Itali në mënyrë ilegale. Së bashku me këtë vajzë, kam qëndruar në një shtëpi. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Shokët e babait tim kanë ardhur në shtëpinë tonë dhe më kanë ofruar punë në një restorant ushqimor por marrëveshja ka qenë se ata (shokët e babait tim) do të më sjellin dhe do të më përcjellin në shtëpi çdo ditë. Qysh ditën e parë, pronari më ka lidhur, mi ka mbyllur sytë dhe më ka dhunuar. Ditën tjetër, ai më ka detyruar të kem marrëdhënie me disa persona nga Shqipëria. Kjo ka vazhduar në baza të rregullta dhe në fund, më ka shitur te pesë njerëz të cilët më kanë dhunuar dhe më vonë të gjashtë vëllezër të cilët me kanë keqtrajtuar seksualisht. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Personi primar i cili më ka ofruar punë ka qenë shoqja ime. Ajo ka qenë shoqe me pronarët e këtyre klubeve. Shoqja ime ka qenë më e re se 18 vjet përderisa viktimat tjera kanë qenë të moshave të ndryshme (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Personi që ma ka ofruar këtë punë (ku ka qenë e trafikuar) ka punuar me vëllezërit e saj të moshës mesatare. Ai ka qenë shok i babait tim dhe i dhëndrit tim. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Unë kam komunikuar më këtë vajzë nëpërmes telefonit. Ajo ka qenë një grua nga Moldavia, prej tridhjetepesë deri në dyzet vjet. Nuk e di se çfarë profesioni ka pasur por e di që me mua është sjell mirë. Nuk ka pasur ndërmejsues tjerë. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Personi i cili më ka dhënë punë ka qenë 18 vjeçar, Shqiptar nga Kosova, shok i burrit tim të cilin e kam takuar pasi që jam martuar. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Fqiu im më ka bërë këtë ofertë. Ai është një biznesmen, rreth pesëdhjetë vjeçar. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Shqipëria, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Këtë punë e kam marr nga një kolege e imja e cila më parë ka punuar në Kosovë. Ajo është shoqe me mua dhe ajo më ka treguar për këtë mundësi. (Viktimë e trafikimit, Bullgare, moshë në mes 36 dhe 40 vjet)

Megjithatë, duke gjykuar në bazë të intervistave, sigurimi i punësimit nuk është mënyra e vetme se si vajzat e reja dhe femrat janë viktimizuar. Mënyra se si trafikantët i joshin viktimat janë shumë të ashpra në rastin e vajzave të reja. Shembujt e dhënë nga respondentët përfshijnë kidnapime brutale, dhunim dhe konsumim të alkoolit me dhunë (e me siguri edhe të narkotikëve, sipas intervistave me klientët e punonjësve komercial të seksit). Viktimat zakonisht mbahet të mbyllura dhe ikja nuk është opsion për shkak të frikës dhe keqtrajtimit fizik të shpeshtë.

Një ditë, një shoqe e imja ka ardhur në shkollë me disa shokë të saj të cilët më kanë marrë me forcë. Ajo ka ardhur disa herë para se të më merrnin me dhunë. Kur më kanë marr, ajo më ka detyruar të kem marrëdhënie seksuale me shokët e saj. Kjo ka ndodhur disa herë në vende të ndryshme të Kosovës ku jam mbajtur me dhunë në vende të mbyllura. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Burri i motrës time më ka thënë të shkojë në një fshat për t'i marr disa të holla të cilat disa njerëz ia kanë pasur borxh dhëndrit tim. Atje kanë qenë disa njerëz me të cilët më njoftoj burri i motrës time, këta nuk i kam parë kurrë më parë në jetën time. Ai më la atje dhe shkoj... Pasi që më kanë dhënë një pije, unë e kam humbur vetëdijen dhe kur jam zgjuar, e kam parë një njeri të moshës pesëdhjetë vjeçare të shtrirë në shtrat me mua. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

E kam takuar një shoqe dhe jam bërë shumë e afërt me të. Ne jemi shoqëruar një kohë të gjatë dhe pastaj ajo më ka njoftuar me disa shokë të saj... Ne i kemi takuar disa djem të vendeve tjera të Kosovës të cilët na kanë marrë me dhunë dhe na kanë dërguar në një restorant, prej të cilit nuk kemi mundur të ikim dhe kështu ka filluar ferri për ne. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 21 dhe 25 vjet)

Në fillim, nuk kam pasur ofertë për punë por vetëm jam shoqëruar me këtë vajzë. Ka qenë shoqja ime ajo që më ka bërë të zhytem në këto ujëra të ndyta. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 21 dhe 25 vjet)

Koha e kaluar si viktimë e trafikimit

Ø Lokacionet

Të gjitha vajzat/femrat e intervistuar kanë qenë të eksploatuara seksualisht. Disa nga to kanë punuar në lokale ku shërbehet ushqimi (klube të natës, restorantet, etj.). Zakonisht, ato kanë punuar si kameriere përgjatë ditës ndërsa natën kanë punuar si prostitute, duke i pranuar klientët. Përveç se janë eksploatuar seksualisht, vajzat nuk janë paguar për punën e tyre. Disa kanë punuar për bukë dhe cigare. Shumica kanë qenë të detyruara të japin shërbime seksuale, por disa kanë qenë vullnetare dhe këtë e kanë bërë për para. Edhe pse është vështirë të konkludohet për shkak të numrit të vogël të intervistave të kryera, duket se vajzat më të "vjetra" dhe femrat janë marrë me

prostitucion ndonjëherë vullnetarisht përderisa vajzat më të reja zakonisht kanë qenë të detyruara me forcë.

Gjatë ditës kam punuar si kameriere ndërsa gjatë natës pronari më ka shitur tek njerëz të ndryshëm. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Kurrë nuk kam marrë ndonjë pagë për punën që e kam bërë, dhe krejt çka kam marrë ka qenë ushqim dhe cigare. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Shqipëria, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Në fillim, kam punuar me klientët; Kurrë nuk kam marrë para, absolutisht asnjëherë. Kur kam punuar me personin e parë, nuk kam punuar. Ai më ka dhënë të holla. Më vonë, kur kam jetuar me një person tjetër, kam punuar vetë dhe i kam pasur paratë e mia. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Kam punuar, kam shërbyer dhe sipas urdhrave të pronarit tim i kam shoqëruar mysafirët e tij deri në orët e hershme të mëngjesit. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Shqipëria, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Unë kam punuar tri ditë në lokal si kameriere dhe kam qenë me forcë e detyruar të rri prej orës 14.00-01.00 por tri ditë të javës, jam detyruar të rri tërë natën. Unë nuk jam paguar për punën që kam bërë gjatë këtyre tri ditëve por pronari më ka dhënë ushqim dhe cigare. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Në disa vende ku kemi jetuar, ne kemi qenë të detyruara të punojmë si kameriere, përderisa në vendet tjera ne kemi qenë të mbyllura dhe na kanë thirrur vetëm kur kanë pasur nevojë për ne, atëherë kur kanë ardhur klientë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 21 dhe 25 vjet)

Nuk ka pasur dhunë por ne kemi qenë si të burgosura. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Unë i kam ofruar shërbime mysafirëve të pronarit dhe më kanë ofruar para nëse ju kam dhënë shërbime seksuale. Kam vendosur ta pranojë ofertën sepse kam dashur të fitoj më shumë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Ø Origjina e viktimave

Në vendet ku kanë punuar, vajzat/femrat kanë takuar viktimat të tjera. Viktimat kanë qenë vajza/femra tjera të grupmoshave të ndryshme, zakonisht prej moshës 16 deri në të njëzetat e vonshme. Këto vajza kanë qenë prej vendeve të ndryshme; shumica nga Kosova, por disa kanë ardhur nga Bullgaria, Moldavia, Shqipëria, etj.

Atje kanë qenë dy vajza tjera shqiptare – kosovare, njëra ka qenë njëzet e tri vjeçare ndërsa tjetra ka qenë dyzet e katër vjeçare. Ato janë trajtuar në mënyrë të njëjtë si unë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Po, atje ka pasur vajza tjera dhe të gjitha kanë qenë nga Moldavia. Moshë e vajzave të cilat kanë punuar atje ka qenë mesatarisht prej njëzet e katër deri në tridhjetë vjet. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Shumica e vajzave kanë qenë Kosovare, zakonisht prej moshës gjashtëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 26 dhe 30 vjet)

Në këto vende shumë vajza kanë qenë nga Kosova, Shqipëria, Bullgaria. Ato kanë qenë prej pesëmbëdhjetë deri në njëzet e shtatë vjet. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 21 dhe 25 vjet)

Atje ka pasur femra tjera në atë vend dhe shumica e tyre kanë qenë nga Bullgaria. Moshë mesatare ka qenë tridhjetepesë vjet, edhe pse ka pasur disa që kanë qenë edhe më të vjetra. (Viktimë e trafikimit, Bullgare, moshë në mes 36 dhe 40 vjet)

Ø **Keqtrajtues potencial seksual**

Prism-a gjithashtu ka qenë e interesuar në përcaktimin e klientëve “tipik” të prostitutave, duke i përfshirë edhe femrat e trafikuar. Vajzat dhe femrat kanë treguar se personat kanë qenë të moshave të ndryshme, prej atyre shumë të ri deri në ata të moshës mesatare. Sa i përket grupeve etnike të klientëve, disa nga vajzat kanë raportuar se janë vizituar vetëm nga Shqiptarë nga Kosova përderisa të tjerat kanë thënë se kanë pasur klientë të nacionaliteteve të ndryshme. Vajzat supozojmë, e disa edhe deklarojnë me siguri, se klientët e tyre kanë qenë klientë me situatë të mirë financiare.

Ata kanë qenë të moshave të ndryshme, të ri prej moshës tetëmbëdhjetë deri në njëzet e nëntë. Ata të gjithë kanë qenë shqiptarë nga Kosova dhe janë dukur se janë të pasur. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Ata kanë qenë të moshave të ndryshme, nga njëzet deri në pesëdhjetë vjet. Të gjithë kanë qenë shqiptarë nga Kosova. Në mesin e tyre ka pasur menaxherë të bankave dhe këta kanë qenë njerëz të pasur. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Ata të gjithë kanë qenë shqiptarë nga Kosova, përveç një mashkulli i cili ka qenë nga Shqipëria dhe më duket se ai ka qenë i pasur. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Këtu, personat që kanë përdorur shërbimet e mia kanë qenë nga Shqipëria dhe Kosova. Ata kanë qenë financiarisht stabil, sepse më kanë gostitur pije duke paguar deri në 30 marka gjermane⁷. Ata përafërsisht kanë qenë të moshës së mesme dhe në disa raste kanë qenë të martuar. Unë mendoj se shumë nga ata kanë qenë duke punuar jashtë vendit. (Viktimë e trafikimit, Ruse, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Personat që i kanë përdorur shërbimet e nga unë kanë qenë nga moshë 20 vjet deri tek pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë vjet. Kryesisht këta kanë qenë persona që vijnë nga

⁷ Respondenti ju ka referuar kohës para se valuta Euro ka filluar të aplikohet në Kosovë, para 1 janarit, 2002.

vendet e jashtme. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 26 dhe 30 vjet)

Jeta pas shpëtimit

Ø Arratisja nga trafikimi i qenieve njerëzore

Vajzat e intervistuar kanë arritur të arratisen nga situata e keqe në të cilat janë gjetur në mënyra të ndryshme. Shumica nga ato janë shpëtuar gjatë kontrollit të policisë. Disa kanë arritur të arratisen nga vendet ku kanë qenë duke u mbajtur, ndonjëherë pasi që kanë pasur disa tentativa të pasuksesshme të arratisjes më herët. Pasi që janë intervistuar nga policia, vajzat zakonisht kanë përfunduar nëpër “shtëpitë e sigurta” ku ato raportojnë të kenë hasur mikpritësi të ngrohtë dhe ndihmë.

Policia na ka ndalur derisa kemi qenë në veturë dhe na kanë dërguar në stacion të policisë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Nga ai vend kam arritur të arratisem dhe pastaj kam shkuar në shtëpi, mirëpo këta njerëz më kanë takuar sërish në qytet pas katër apo pesë muaj dhe më kanë marrë me forcë. Ne kemi qenë duke shkuar diku mirëpo në mes të rrugës na ka ndalur policia dhe na kanë dërguar në stacion të policisë. Nga aty, ne jemi dërguar në strehimore. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Kam qenë shtatzënë dhe kam shfrytëzuar rastin të arratisem dhe kam blerë ca rroba për vete. Më pastaj, kam shkuar në stacion të policisë prej nga më kanë dërguar në strehimore derisa kam lindur fëmijën. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 26 dhe 30 vjet)

Kam arritur të arratisem dhe kam dal në rrugë, kam ndalur disa vetura në mënyrë që të shkoj në _____ dhe në polici. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 21 dhe 25 vjet)

Pos asaj që kanë qëndruar në “shtëpi të sigurta”, shumica e vajzave/femrave kanë pohuar se nuk kanë pranuar ndonjë ndihmë tjetër nga autoritetet qeveritare apo nga organizatat të cilat e luftojnë trafikimin. Një vajzë ka pohuar për një përjetim tejet negativ me policinë lokale, e cila po ashtu ka deklaruar se ka qenë fizikisht e keqtrajtuar nga policia.

Është njohuri e përgjithshme se viktimat e mbijetuarat e arratisura nga trafikantët dhe të shtyra në prostitucion shpesh stigmatizohen dhe përjashtohen nga shoqëria. Është posaçërisht brengosëse se këto vajza shpesh janë të braktisura edhe nga familjet e tyre, gjë që paraqet barrierë në reintegrimin e tyre social dhe mund të shpij sërish në trafikim.

Jo, askush nuk më ka ndihmuar përderisa kam qenë e vendosur në shtëpinë e sigurt. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Jo, askush nuk më ndihmuar asnjë herë. Disa herë derisa kam qenë në qytet kam takuar dhe ju afruar policëve për t'i paraqitur brengat dhe problemet e mia mirëpo nuk

kam hasur në përkrahje. Kur më kanë dërguar në stacion të policisë, më kanë keqtrajtuar fizikisht. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Më kanë dërguar në strehimore ku kam ndier ngrohtësi dhe mikpritje, për mua dhe fëmijën tim. Po ashtu, më kanë ndihmuar të liroj edhe motrën time nga përdoruesit. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 16 dhe 20 vjet)

Pasi që jam marrë në pyetje nga policia, më kanë dërguar në strehimore ku jam rehabilituar për një kohë të gjatë. Gjatë kohës që kam qëndruar aty, na kanë vizituar punonjësit e Qendrës për Punë Sociale, si dhe na kanë vizituar zyrtarë nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 21 dhe 25 vjet)

Nuk kam qenë e ndihmuar nga askush, qoftë nga ndonjë organizatë apo institucion. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 31 dhe 35 vjet)

Lidhur me përkrahjen nga familja ime, shpesh kam humbur të gjitha shpresat. Në këtë vend ku jetoj, njerëzit nuk mund të më ndihmojnë ashtu siç jam. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 21 dhe 25 vjet)

Ø **Për një të ardhme më të mirë**

Tani që janë të mbijetuara, vajzat/femrat shpresojnë për një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme. Varësisht nga mosha e tyre, pritjet zakonisht përfshijnë gjërat si përfundimi i shkollës apo krijimi i familjeve. Ato shpresojnë se do të mbështeten nga institucionet dhe organizatat relevante në procesin e rehabilitimit, gjetjes së një pune të ligjshme dhe ofrimin e shansës për të jetuar një jetë normale. Disa nga ato që janë intervistuar, raportojnë stres traumatik si pasojë e përjetimeve të tyre. Vëmendje e veçantë profesionale është e nevojshme për mbështetje dhe rehabilitim. Do të ishte ideale sikur vajzave të reja t'ju jepet shanca për jetë normale dhe produktive përmes asistencës në arsimim, trajnime profesionale dhe punësim sepse pavarësia e tyre financiare është një nga parakushtet që viktimat në mënyrë permanente të tërhiqen nga trafikimi dhe nga jeta të cilën e kanë jetuar deri tani.

Tani shpresat e mia janë të kthehem në familje dhe të vazhdojë shkollimin. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Mendoj për të ardhmen time si një të ardhme të lumtur, e ndryshme nga ajo që ka qenë deri tani. Dua të jem e vetëdijshme, e mirësjellshme, ta respektojë familjen time, t'i dëgjoj ata dhe të shkojë përsëri në shkollë. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, më e re se 15 vjet)

Gjithmonë kam menduar për mënyrat se si mund të kthehem në shtëpi. Tani shpresoj se shumë shpejt unë do të jem në gjendje të kthehem në shtëpi dhe të mos lejojë gjëra si këto të më ndodhin. Dua të përkujdesem për familjen time. Nëse do të mund të shkollohesha, do të dëshiroja të shkoja në shkollë apo të gjejë ndonjë punë, në ndonjë butik, afër shtëpisë sime. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, mosha në mes 16 dhe 20 vjet)

Shpresat e mia për të ardhmen pothuajse nuk ekzistojnë. Jam ndier pakëz e relaksuar kur kriminelët (trafikantët) janë akuzuar por prapë se prapë unë vazhdoj të jem një top i plastikës. Nëse do të kisha kulm mbi kokë apo ndonjë vend ku mund të rrija, unë do të punoja për ta mbështetur veten dhe kurrë nuk do ta përsërisja rrugën që ma ka shkatërruar jetën pa dëshirën time. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Shpresoj se ju do të iniconi ndonjë program për rehabilitimin e vajzave sikur unë sepse nuk jemi pak. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Dua ta jetoj jetën time të qetë bashkë me fëmijën tim. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 26 dhe 30 vjet)

Tani, jam bashkë me motrën time dhe djalin tim të vogël dhe jam e punësuar. Dua të jetoj e qetë me të dashurit e mi. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 16 dhe 20 vjet)

Do të dëshiroja shumë që ta ktheja kohën dhe të isha më e kujdesshme në veprimet e mia. Sikur ta kisha forcën të ballafaqohem me probleme më lehtë dhe të kisha besim për tejkalimin e tyre. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 21 dhe 25 vjet)

Do të dëshiroja të kisha familje të lumtur dhe të bëhem nënë e mirë. Nëse kam mundësi, do t'i këshilloja të gjitha femrat që të mos futen në trafikim. Ato nuk duhet të jepen pas parave të lehta dhe ta humbin dinjitetin e tyre njerëzor. (Viktimë e trafikimit, Shqiptare nga Kosova, moshë në mes 31 dhe 35 vjet)

Përderisa ekzistojnë debate publike për trafikimin dhe përkundër gjetjeve të këtij hulumtimi të cilat tregojnë se publiku kosovar, duke i përfshirë grupet me rrezikshmëri të lartë, janë deri diku të vetëdijshëm për këtë problem; është e dyshimtë se kosovarët janë plotësisht të vetëdijshëm për barbarizmin e trafikantëve. Tregimet shokuese të këtyre individëve qartë tregojnë natyrën e vërtetë të këtij krimi dhe mund të shfrytëzohen në krijimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes e cila do të kontribuonte në të kuptuarit më të madh të problemit të trafikimit në Kosovë.

9. Gjetjet – Intervistat me klientët e punëtorëve të seksit komercial

Kjo pjesë e hulumtimit kualitativ është dizajnuar për të mësuar më shumë për njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet e personave të cilët i përdorin shërbimet e prostitutave. Përgjithësisht, 18 intervista janë kryer në pjesë të ndryshme të Kosovës (*shih Tabelën 18. për demografi*). Udhëzuesit e përdorur për intervista kanë përcjellur në mënyrë tematike pyetësorin e hulumtimit i cili është përdorur në hulumtimin e popullatës së përgjithshme që e përmendëm paraprkisht. Kriteri i përdorur për selektimin e respondentëve ka qenë: pasja seks me prostitute brenda vitit të fundit. Në atë mënyrë ne kemi tentuar të kuptojmë mendime, motive dhe informata për personat që i vizitojnë punëtorët e seksit disa nga të cilat mund të jenë viktimat e trafikimit. Përjetimet e respondentëve tonë ndryshojnë, disa janë vizitorë të rregullt apo herëpashershëm të këtyre vendeve, përderisa të tjerët në mënyrë hipokrite deklarojnë se janë kundër prostitucionit. Në këtë mënyrë në kemi tentuar të kuptojmë më shumë për ata që janë më të prirur t'i takojnë viktimat e trafikimit më shumë se kushdo tjetër. Ky hulumtim i qaset problemit nga këndet e ndryshme duke u bazuar në audiencë dhe përjetime të ndryshme.

Tabela 18. Demografia – Klientët e punëtorëve të seksit komercial

		Numri i intervistave
MOSHA	20-25	4
	26-30	5
	31-35	5
	>35	4
LLOJI I VENDBANIMIT	Urban	9
	Rural	9
ARSIMIMI	Nuk e ka përfunduar shkollën fillore	1
	E ka përfunduar shkollën fillore	4
	E ka përfunduar shkollën e mesme	9
	Shkolla e lartë apo fakulteti	4
GRUPI ETNIK	Shqiptar	12
	Serb	6

Njohuria mbi trafikim

Pjesa fillestare e intervistave të kryera me klientë ka qenë lidhur me vlerësimin e tanishëm të situatës socio-ekonomike dhe problemeve tjera me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Për respondentët, situata në Kosovë perceptohet si e keqe; qytetarët ballafaqohen me papunësi dhe varfëri, e cila, sipas respondentëve tanë, ndikon tek e gjithë popullsia. Pastaj, Prism ka inicuar pyetje lidhur me trafikimin, duke pyetur respondentët se çfarë ju bie së pari ndër mend kur përmendet kjo frazë. Shumica e respondentëve e kanë lidhur termin me aktivitet kriminal. Të tjerët kanë vërejtur lidhshmërinë në mes të trafikimit dhe shfrytëzimit të personave të pafajshëm me qëllim të përfitimeve financiare. Trafikimi i qenieve njerëzore perceptohet të jetë e lidhur me femra të cilat janë viktimat kryesore, që përdoren për prostitucion.

Gjëja e parë që më bie ndër mend kur dëgjoj për trafikimin e qenieve njerëzore është trafikimi i femrave për përfitime personale të personave të pandërgjegjshëm. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Gjërat e para që më vine ndër mend kur përmendet trafikimi është: aktivitet joligjor dhe keqtrajtimi që disa persona ndërmarrin ndaj femrave. (Prishtinë, Zonë me shumicë shqiptare)

Kur dëgjoj fjalë trafikim, unë mendoj për një fenomen tejet të keq në shitblerjen joligjore, prostitucionin. Në fakt, kjo është shitja joligjore e femrave. (Prishtinë, Zonë me shumicë shqiptare)

Gjëja e parë që më vjen ndër mend kur dëgjoj këtë fjalë është një grup njerëzisht që i takojnë mafias dhe i shet femrat për prostitucion, për para. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Kur dëgjoj për trafikimin, gjëja që e ndërlidhi është se ka të bëj me diçka që kam dëgjuar në televizion, praktikimi i prostitucionit. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Gjëja e parë që më bie ndër mend janë xhirime të shumta në televizion dhe reklama që kam parë, shtëpitë e sigurta, dhe institucionet tjera që luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Kur dëgjoj këtë shprehje mendoj për shitjen e mallit. Jam i informuar për këtë shprehje, dhe se çfarë ajo nënkupton. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Tjetër, Prism ka pyetur respondentët të definojnë shprehjen "trafikimi i qenieve njerëzore." Në vijë me përgjigjet e mëhershme, shprehja është definuar si njëra nga format më serioze të krimit që përfshin: blerja apo shitja e qenieve njerëzore, trajtimi i qenieve njerëzore si mallra, të gjitha këto me qëllim të përfitimeve materiale. Disa respondentë besojnë se krimi i organizuar, mafia, qëndron prapa trafikimit. Ngjashëm me sondazhin me popullsinë e përgjithshme, trafikimi shpesh është identifikuar nga klientët me prostitucion. Është e definuar me transportimin e personave nga një shtet në tjetrin me qëllim të shfrytëzimit. Disa respondentë nuk kanë qenë në gjendje që qartazi të definojnë shprehjen mirëpo kanë shprehur besimin se përfshin përdorimin e dhunës, si fizike ashtu edhe psikike. Respondentët tjerë kanë vlerësuar se viktimat e trafikimit mbahen kundër dëshirës së vet.

Trafikimi i qenieve njerëzore në shprehje të thjeshta është shitja e personave me qëllim të shfrytëzimit. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Trafikimi është kur vajzat e reja blihen nga Moldavia, Shqipëria dhe Kosova dhe shiten për para, janë të shtyra të punojnë si prostituta. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Trafikimi është krim i organizuar. Vetëm kriminelët mund të organizojnë një aktivitet të tillë. Trafikantët përdorin viktimat e tyre në mënyrë çnjerëzore. Ata i keqtrajtojnë viktimat, dhe sillen shumë keq me to. (Podujevë, Zonë me shumicë shqiptare)

Nuk e di se çfarë do të thotë trafikimi i qenieve njerëzore. Mirëpo, e di se trafikantët i abuzojnë viktimat e tyre. Ata i mashtrojnë ato, i shfrytëzojnë dhe i dhunojnë. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Trafikimi i qenieve njerëzore është trajtimi i njerëzve si mallra. Trafikantët në mënyrë çnjerëzore i trajtojnë viktimat dhe i abuzojnë në mënyra të ndryshme. (Mitrovicë, Zonë me shumicë serbe)

Trafikimi i qenieve njerëzore përfshin dhunë fizike dhe lloje të ndryshme të dhunës ndaj njerëzve. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Shprehja tregon një aktivitet joligjor, e cila përfshin transportimin joligjor të personit prej një shteti në shtetin tjetër, prej grupeve kriminale me qëllim të shfrytëzimit të këtyre personave në mënyra të ndryshme. Trafikantët i shfrytëzojnë viktimat e tyre në mënyra të ndryshme. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Shprehja trafikim përfshin trafikimin e punëtorëve të cilët janë të angazhuar në punë ilegale, sikurse punëtorët në shtetet perëndimore dhe trafikimi i punëtorëve në shtëpitë publike. (Prishtinë, Zonë me shumicë shqiptare)

Lidhur me mënyrat se si trafikantët i shfrytëzojnë viktimat e tyre, respondentët pajtohen se qëllim i tyre është që t'i përdorin viktimat për përfitime financiare, shpesh duke i trajtuar ato në mënyrë të vrazhdë dhe johumane. Prostitucioni sërish shpesh është përmendur si mënyra e shfrytëzimit. Për më tepër, trafikantët e qenieve njerëzore janë cilësuar se i përdorin viktimat e tyre si forcë e lirë punëtore, dhe fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar për kërkim lëmoshë të organizuar. Një numër i madh i respondentëve po ashtu kanë përmendur se personat e trafikuar përdoren për shitje të narkotikëve. Në mënyrë specifike, ata kanë përmendur shembuj të fëmijëve që shesin narkotik fëmijëve të tjerë, të cilat i kanë marrë nga shitësit e drogës.

Viktimat abuzohen nga trafikantët, të cilët i burgosin viktimat e tyre për interesa të tyre. Ata i shesin ato për para, i keqtrajtojnë, i japin drogë, mirëpo unë mendoj se po ashtu ka raste kur prostitutat nuk abuzohen. (Prishtinë, Zonë me shumicë shqiptare)

Viktimat shfrytëzohen nga trafikantët në forma të ndryshme, siç është shtytja të kryejnë shërbime seksuale kundër dëshirës së tyre, të angazhohen në punë të vështirë dhe të mundimshme, dhe aktivitete të shumta tjera joligjore. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Trafikantët shfrytëzojnë viktimat e tyre seksualisht, në farma (për punë bujqësore), dhe në rrugë ku njerëzit me aftësi të kufizuar janë të shtyre të kërkojnë lëmoshë. Ata po ashtu shfrytëzojnë fëmijët të shesin drogë moshatarëve të tyre. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Trafikantët e qenieve njerëzore shfrytëzojnë viktimat e tyre nëpërmjet formave të ndryshme: fizikisht dhe seksualisht, dhe të shesin drogë. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Klientët pajtohen se femrat – më së shpeshti femrat e reja dhe vajzat – janë viktimat kryesore të trafikimit. Vajzat e reja të trafikuar vijnë nga familje të ngjashme me status të ngjashëm socio-ekonomik. Sipas respondentëve tanë, trafikantët i shënojnë personat të cilët në ndonjë mënyrë janë më të cenueshëm. Viktimat zakonisht vijnë nga familjet jo stabile, me nivel të ulët arsimimi dhe që ballafaqohen me situata të vështira financiare. Niveli i ulët i arsimimit ndërlidhet me situatën e vështirë financiare, dhe po ashtu për mungesën e inteligjencës, sipas disa respondentëve. Ky perceptim implikon se klientët i shohin viktimat si më pak inteligjente se femrat tjera të reja. Disa respondentë besojnë se viktimat kanë nivel të “dyshimtë të moralit” që është njëra nga arsyet pse ato janë trafikuar. Klientët besojnë se këto arsye, së bashku me dëshirën e femrave të reja për të fituar të holla, ndikojnë që këto vajza të biejnë pre e trafikantëve të qenieve njerëzore. Sa i përket nacionalitetit të viktimave, respondentët në përgjithësi pajtohen se ato janë femra nga viset rurale të

Kosovës. Disa respondentë besojnë se shumë viktime vijnë vendet e jashtme. Disa respondentë ngatërrojnë trafikimin me prostitucion me vetëdëshirë. Kjo e gjetur indikative këtu është në harmoni me shumë të gjetura tjera nga pjesa kuantitative e hulumtimit. Për shembull, si klientët ashtu edhe popullsia e përgjithshme pajtohen se femrat e reja dhe vajzat janë jo vetëm viktimat kryesore por po ashtu edhe në rrezikun më të madh të trafikohen.

Shpesh viktimat e trafikimit janë vajza më të reja se 18 vjeç. Ato vijnë nga familjet e varfër që nuk kanë të hyra. Si të tilla, ato kërkojnë ardhmëri më të ndritshme dhe lehtë mashtrohen nga trafikantët. Viktimat kërkojnë vend pune që mund t'i zgjidh problemet familjare. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Në përgjithësi, ata që ballafaqohen situatë të vështirë financiare janë në një mënyrë apo tjetrën, viktime potenciale të trafikimit. Ato janë të etura për të provuar çfarëdo qoftë të fitojnë të holla. (Podujevë, Zonë me shumicë shqiptare)

Më së shpeshti, femrat e reja trafikohen, sidomos ato që kanë situatë të vështirë financiare. Ato kanë nivel të ulët të arsimimit dhe raporte të këqija familjare – konflikti është formë e zakonshme e komunikimit. Viktimat kanë standarde të ulëta morale dhe vijnë si nga zonat rurale ashtu edhe nga ato urbane. Megjithatë, unë supozoj se më shumë vijnë nga zonat rurale sepse atje vajzat mashtrohen më lehtë. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Viktimat e trafikimit janë femra nga Moldavia dhe Rusia, por gjithashtu ka femra nga Shqipëria dhe Kosova dhe të gjitha kanë kushte të vështira financiare. Ato vijnë nga fshatra të ndryshme dhe janë të obliguara të punojnë punë të ndryshme. Këto femra janë të paarsimuara; ato janë të reja dhe lehtë mashtrohen për para. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë e di që viktimat e trafikimit janë në këtë biznes për shkak se atyre ju pëlqen një gjë e tillë dhe për shkak të parave që i fitojnë. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Shumica e viktimave janë të reja dhe janë të ndishme, janë femra të reja të cilat nuk janë të informuara se si të kërkojnë punë. Ato janë të varfra (nuk kanë para për arsimim të mëtutjeshëm), nuk janë të arsimuara dhe vijnë nga vendbanimet që janë më pak të banuara. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Në rrezik më të lartë janë femrat e reja të cilat kërkojnë punësim me anë të shpalljeve. Këto janë adoleshente të cilave ju nevojiten të hollat për t'u arsimuar. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Grupet të cilat janë në rrezik më të madh për tu trafikuar janë vajzat e reja të cilat janë të paarsimuara, kanë inteligjencë të ulët, janë të pamoralshme dhe vijnë nga fshatrat. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Kur janë pyetur se kush është përgjegjës për parandalimin e trafikimit, përgjigjet kanë qenë të ndryshme. Disa nga respondentët ja kanë vënë përgjegjësinë shoqërisë në përgjithësi, duke argumentuar se qytetarët janë ata që duhet ta luftojnë trafikimin duke bashkëpunuar me agjencitë për përforcimin e ligjit. Të tjerët ja kanë vënë përgjegjësinë organizatave dhe institucioneve specifike. Klientët besojnë se prania dhe ekzistimi i trafikimit është një njohuri e zakonshme prandaj bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe ligjvënësve mund të kontribuojë në masë të madhe në

luftën kundër këtij problemi. Disa respondentë kanë theksuar se organizatat qeveritare dhe joqeveritare duhet t'i japin fund veprimeve të tilla kriminele. Përgjigjet tregojnë se klientët besojnë se policia dhe gjykatat luajnë rolin më të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit – njëjtë sikur tek popullata në përgjithësi, duke i përforcuar ligjet ekzistuese. Vetëm një numër i vogël i respondentëve i kanë fajësuar trafikantët për trafikim të qenieve njerëzore, gjë e cila dallon nga rezultatet e hulumtimit në publik. Përgjigjet tjera janë të ngjashme me ato që janë marrë nga hulumtimi kuantitativ.

Institucionet më përgjegjëse në parandalimin e trafikimit janë ato gjyqësore. Sistemi gjyqësor duhet të përkujdeset për mbizotërimin e ligjit dhe rendit në vend. Qytetarët janë gjithashtu përgjegjës dhe ata nuk bashkëpunojnë me institucionet aq sa duhet në luftimin e kësaj dukurie. Qytetarët të cilët hasin në çfarëdo veprimi të trafikimit të qenieve njerëzore duhet ta ndajnë këtë informatë dhe këtë njohuri me institucionet përkatëse. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Policia e ka përgjegjësinë për luftimin e trafikimit. Ata nuk janë duke e luftuar këtë dukuri me forcë të mjaftueshme sa për ta larguar atë nga shoqëria jonë. (Podujeve, Zonë me shumicë shqiptare)

Njerëzit të cilët janë përgjegjës për trafikim të qenieve njerëzore janë trafikantët, qytetarët, klientët e prostitutave, policia dhe institucionet tjera. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Përgjegjësia për trafikim bien në pronarët e lokaleve të cilët i punësojnë këto femra dhe i shfrytëzojnë ato për prostitucion dhe trafikim. Unë mendoj se Shërbimi Policor i Kosovës duhet ta luftojë këtë dhe të sigurohet se trafikimi të mos përhapet kaq shumë në Kosovë. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Sa i përket çështjes së trafikimit, sipas mendimit tim, policia e UNMIK-ut si dhe Shërbimi Policor i Kosovës duhet të jenë përgjegjës. Është përgjegjësi e tyre që t'i mbyllin këto klube të natës. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Përgjegjësia për trafikim bien në pronarët e klubeve, polici, UNMIK dhe qeveri. Unë mendoj se këto janë entitetet që duhet ta luftojnë trafikimin. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

E tërë shoqëria është përgjegjëse për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, sepse nëse ne si tërësi nuk ngritemi ta luftojmë këtë dukuri, atëherë ne dukshëm jemi duke e mbështetur atë. Për më shumë, përgjegjësia bien në Qendrat për Punë Sociale dhe organizatat joqeveritare të cilat e luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Qeveria e bart përgjegjësinë për luftimin e problemit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe ata nuk janë të vetëdijshtëm se sa është i pranishëm ky problem në Kosovë. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Trafikimi i njerëzve në Kosovë

Një shumicë e madhe e respondentëve në hulumtimin kuantitativ janë pajtuar se trafikimi i qenieve njerëzore është i pranishëm në Kosovë, duke qenë shumë apo deri diku i përhapur. Këtë e mendojnë edhe klientët e hulumtimit kualitativ. Informatat e tyre për trafikimin në Kosovë vijnë nga burime të ndryshme. Shumica e tyre kanë kuptuar për trafikimin nga mediat – më së shumti nga televizionet dhe gazetatat. Për më tepër, klientët kanë mësuar për trafikimin nga shokët apo të afërmit e tyre. Disa respondentë kanë thënë se ata kanë mësuar për trafikimin në Kosovë drejtpërdrejtë nga viktimat. Kjo është referencë duke i vizituar prostitutat. Gjithashtu, kjo i referohet identifikimit të lokaleve të tilla në komunitetet e tyre ku viktimat e trafikimit besohet se janë trafikuar.

Prostitucioni, si forma më e zakonshme e qenieve njerëzore, është shumë i përhapur. Gjatë viteve të fundit, prostitucioni është zgjeruar shumë shpejt. Vazhdimisht, bordele të reja janë hapur dhe shumë pak nga këto janë mbyllur. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Trafikimi në Kosovë është deri diku i përhapur. Për trafikimin e qenieve njerëzore kam dëgjuar nga shokët e mi, televizioni, radio dhe të afërmit. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Problemi i trafikimit të qenieve njerëzore është i përhapur në tërë rajonin e Kosovës. Unë këto informata i kam marrë nga televizioni dhe gazetatat. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Pasi që unë ndonjëherë i vizitoj klubet ku ka prostitucion, unë e kam parë nivelin e tij (trafikimit) të pranishëm gjatë eksperiencës time. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë kam dëgjuar për trafikimin e qenieve njerëzore nga burimet e ndryshme. Kryesisht, kam dëgjuar nga fqinjët e mi, pasi që shpesh i diskutojmë këto gjëra. (Podujeve, Zonë me shumicë shqiptare)

Më së shumti, unë kam dëgjuar për trafikimin nga gazetatat. Unë kam menduar se femrat janë vullnetarisht të përfshira në aktivitetet e tilla, mirëpo, më vonë, nëpërmes mediave e kam kuptuar se ato janë të detyruara dhunshëm të punojnë si prostitute dhe kjo më ka shtyrë t'i urrej këta njerëz. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Për trafikimin e qenieve njerëzore unë kam mësuar nëpërmes diskutimeve me shokët e mi, kolegët e punës, gazetatat dhe TV. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Duke e marrë parasysh njohurinë e respondentëve për këtë çështje, nuk është befasuese se ata janë të brengosur me përhapjen e këtij problemi. Trafikimi besohet se është shumë i lidhur me varfëri. Respondentët pajtohen se të gjithë kosovarët duhet të jenë të brengosur për trafikimin në komunitetet e tyre sepse kjo mund të ndikojë në jetën e tyre. Në lidhje me këtë, shumë respondentë kanë shprehur brengën për rrezikun e trafikimit për të afërmit e tyre. Respondentët i vizitojnë këto vende ku viktimat e trafikimit mund të punojnë prandaj ata janë të brengosur për shëndetin e tyre. Ata të cilët janë intervistuar e cekin një problem tjetër të lidhur me prostitucionin – sëmundjet e transmetuara seksualisht. Disa respondentë përmendin kushtet e jetesës të prostitutave të cilat janë johigjienike, duke e përfshirë faktin se këto femra nuk kanë qasje në kujdesin mjekësor. Një gjë e tillë e rrit rrezikun e sëmundjes.

Ne jemi mjaft të brengosur për problemin e trafikimit të qenieve njerëzore, dhe ne shpresojmë se një formë e parandalimit duhet të merret. Viktimat e trafikimit janë të përfshira si prostitute dhe njerëzit e ri shumë shpesh i frekuentojnë këto vende. Ata mund të infektohen me virusin HIV/AIDS apo me sëmundje të transmetuara seksualisht. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë jam i brengosur për trafikim sepse është mjaft i përhapur dhe se ka mjaft viktime. Në anën tjetër, mendoj se llojet e tilla të shërbimeve duhet të ekzistojnë sepse janë argëtuese. Jam deri diku i brengosur për të afërmit e mi, veçanërisht nëse përfshihen në këtë çështje dhe bëhen viktime. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë jam i brengosur për këtë dukuri të keqe sepse ti paguan për seks. Mendoj se të tjerët janë të brengosur gjithashtu por thjeshtë ata janë të pamoralshëm. Gjithashtu ekziston mundësia e shpërndarjes së sëmundjeve. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Çdo kosovar është me siguri i brengosur për këtë dukuri. Ky është një problem i cili kërkon qasje serioze dhe duhet të prehet në rrënjë. Unë jam i brengosur për të afërmit e mi, gjithashtu. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Keqtrajtimi seksual i viktimave

Trafikimi në mënyrë tipike identifikohet me prostitucion dhe këta responentë janë të vetëdijshëm që viktimat janë seksualisht të eksploatuar. Klientët kanë cekur se viktimat e trafikimit i janë nënshtruar në mënyrë të njëjtë. Fillimisht, ato janë fizikisht dhe seksualisht të keqtrajtuara, pastaj ato janë të detyruara me forcë t'i japin shërbime seksuale vizitorëve të vendeve ku ato mbahen. Viktimat janë të burgosura nëpërmes kërcënimit dhe abuzimit. Njerëzit të cilët janë apo kanë qenë klientë të punëtorëve të seksit komercial kanë dhënë një numër të shembujve konkret të keqtrajtimit. Tregimet për metodat brutale dhe ofenduese të trafikantëve duke i shfrytëzuar viktimat e tyre janë një njohuri e zakonshme në Kosovë.

Personat e trafikuar janë zakonisht të eksploatuar seksualisht. Ata duhet të punojnë për njerëzit tjerë, të cilët përfitojnë financiarisht nga shërbimi i viktimave si prostitute. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë jam i vetëdijshëm për faktin se trafikantët i eksploatojnë seksualisht viktimat e tyre. Kam dëgjuar për një rast ku një person e ka marrë një vajzë nga Shqipëria që të punojë në klubin e tij si kameriere dhe këngëtare. Më vonë, ai e ka dhunuar atë dhe e ka shndërruar atë në prostitute. Ajo është dhunuar nga shokët e tij dhe ai e ka dërguar atë në qytete tjera për të punuar në klube të natës si prostitute. (Podujeve, Zonë me shumicë shqiptare)

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë zakonisht të eksploatuara seksualisht. Së pari ato dhunohen nga personat që i blejnë ato. Më vonë, ato përfshihen në aktivitete tjera në klube si prostitute. Ato janë të detyruara me forcë të shkojnë me persona tjerë (do të thotë ato shiten) apo ofrojnë shërbime seksuale. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Viktimat e trafikimit më së shpeshti janë të eksploatuara seksualisht. Ato janë të varura nga droga dhe trafikantët, prandaj shumë lehtë mund të manipulohen. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë mendoj se viktimat zakonisht janë të eksploatuara seksualisht dhe unë kam mësuar për këto gjëra nga televizioni. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Kur këto femra bëhen punëtore seksuale, ato trajtohen si shtazë; ato transportohen prej një vendi në vendin tjetër. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Pasi që të gjithë respondentët tanë kanë vizituar hapësirat ku viktimat e trafikuar do të mund të shfrytëzoheshin seksualisht, Prism ka pyetur ata të përshkruajnë një klientë tipik. Ata të cilët janë intervistuar besojnë, duke u bazuar nga eksperiencia e tyre, se karakteristikat e ngjashme të gjithë atyre meshkujve është pasuria e tyre. Të ashqutuajtuarat "shtëpi publike" raportohet se vizitohen nga meshkuj të grupeve etnike të ndryshme, përfshirë vendor dhe ndërkombëtarë. Sa i përket moshës së klientëve, shumica e respondentëve thonë se ndryshon, derisa disa thonë se klientët përfshijnë shumë meshkuj të ri dhe të paarsimuar. Referencat për profesionin e klientëve i është dhënë më së shpeshti nga ana e respondentëve që shpesh frekuentojnë shtëpitë publike. Në anën tjetër, respondentët të cilët pohojnë se nuk i përdorin shërbimet e prostitutave, përshkruajnë shfrytëzuesit e shërbimeve seksuale si amorale dhe kriminale. Këto janë komentet e respondentëve të cilët kanë vizituar prostitutat gjatë vitit të kaluar, por thonë se kanë ndërprerë këtë ves. Gjithsesi se është e mundur që këta respondentë të kenë ndërruar mënyrën siç e trajtojnë një përjetim të tillë dhe tani pendohen. Megjithatë, duhet pasur parasysh se respondentët kanë tendencë të paraqesin veten në mënyrën më të mirë të mundshme dhe mund të zgjedhin përgjigje që janë më të pranueshme nga shoqëria.

Personat që vizitojnë vendet ku prostitucioni ushtrohet janë të grup-moshave të ndryshme, kanë nivel të ndryshëm të arsimimit, dhe kryejnë punë të ndryshme. I takojnë grupeve etnike të ndryshme, ka shqiptar, rom, etj., dhe po ashtu ka edhe ndërkombëtarë që vizitojnë këto vende. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Prostitutat janë rregullisht të vizituara nga biznesmenët, pasi që ata mund të ofrojnë vetes luksin e shpenzimit të hollave në atë mënyrë. Unë njoh shumë njerëz nga fshati im, të cilët janë tregtarë të pasur që janë vizitor të shpeshtë lokaleve dhe klubeve të natës, ku ka prostitucion. (Podujevë, Zonë me shumicë shqiptare)

Ka një lloj të personave që vizitojnë prostitutat: ata të cilët kanë para. Nuk është me rëndësi se sa të moshuar janë, apo të rinj, në qoftë se vijnë nga një rajon apo tjetri, me rëndësi është vetëm se kanë të holla dhe janë të gatshëm të shpenzojnë në shërbime seksuale. Klientët janë të llojllojshëm; ata vijnë nga qarqe të ndryshme. (Podujevë, Zonë me shumicë shqiptare)

Zakonisht, punëtorët e seksit vizitohen nga ata njerëz që shfaqin vlera të ulëta të moralit, përjetojnë stres në punën e tyre çdoditore, dhe dëshirojnë të përjetojnë kënaqësi në fund të ditës. Ata janë financiarisht stabil, dhe shpesh janë të përfshirë në biznese joligjore. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Personat që vizitojnë këto vende janë njerëz të rrezikshëm, të varur nga droga, që nxisin probleme, janë të ashpër dhe të paarsimuar. I takojnë grupmoshave të ndryshme. Po ashtu ka edhe njerëz të mirë që vizitojnë klubet e natës. Ata e bëjnë

këtë për kënaqësi, vetëm të kenë marrëdhënie seksuale. Ata përfundojnë në këto klube kur nuk mund ta kontrollojnë veten. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë mendoj se personat që përdorin këto shërbime janë njerëzit që kanë shumë para, biznesmen, dhe nuk kanë jetë të mirë me partnerët e tyre apo me bashkëshortet. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Personat që vizitojnë klubet e natës janë të ndryshëm. Ata vijnë nga viset urbane dhe rurale. Ata janë njerëz që kanë të holla, disa prej tyre kanë lidhje me grupet kriminale. Kanë moshë të ndryshme. Disa prej këtyre personave kurrë nuk kanë pasur më herët marrëdhënie seksuale. Kjo është zakonisht prezent tek të rinjtë. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Këto vende vizitohen nga njerëzit më të këqij, hajna, pjesëtarë të grupeve kriminale, biznesmen që janë duke e shkatërruar shoqërinë tonë. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Kryesisht këto vende vizitohen nga të rinjtë; në disa raste ata nuk kanë nivel të kënaqshëm të arsimimit. Sa kam arritur të lexoj, pos serbëve, ka edhe shumë ndërkombëtarë që vizitojnë këto vende. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Respodentët përvetësojnë qasje të ndryshme në përshkrimin e vajzave që punojnë në këto vende. Disa përqendrohen në atributet fizike atraktive të vajzave, përdorin të tjerët ofrojnë më shumë informata lidhur me përkatësinë e tyre etnike, moshën, arsimimin dhe prapavijën familjare. Ata pajtohen se vajzat vijnë nga familjet e varfra, zakonisht janë të paarsimuara, nuk kanë eksperiencë të mëhershme të punës, dhe janë në kërkim të parave. Edhe pse jo të gjithë respodentët pajtohen, shumica besojnë se vajzat vijnë nga viset rurale. Zakonisht, këto vajza janë shumë të reja. Disa respodentë deklarojnë se shumica e prostitutave vijnë nga vendet e jashtme, siç është Bullgaria, Moldavia, Shqipëria dhe Rusia, mirëpo një numër i konsiderueshëm janë nga Kosova. Disa respodentë besojnë se vajzat janë të pamoralshme. Të bëhen prostituta ka qenë dëshirë e tyre dhe këtë punë e kryejnë për shkak të hollave. Disa respodentë kanë përgjithësuar për karakterin dhe moralin e vajzave bazuar në përjetimet e veta personale. Ata kanë harruar, se në raste të shpeshta, se disa vajza nuk bëhen prostituta me vetëdëshirë. Megjithatë, është inkurajuese se disa të tjerë janë të vetëdijshëm për këtë fakt.

Punëtorët e seksit kanë paraqitje shumë të bukur. Mua më duken shumë elegante dhe atraktive. Ato janë shumë energjike. (Podujevë, Zonë me shumicë shqiptare)

Prostitutat zakonisht janë vajza të reja nga viset rurale, që nuk kanë punuar askund më parë. Zakonisht janë sllave. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Prostitutat duken fantazi; ato janë të bukura. Zakonisht janë në të njëzetat e hershme, do të thotë prej 20 deri 25 vjet. Ato vijnë nga Moldavia, Bullgaria dhe Shqipëria. (Podujevë, Zonë me shumicë shqiptare)

Prostitutat zakonisht kanë vlera të ulëta, sepse ato ofrojnë trupin e tyre kujt do që ka të holla. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Prostitutat janë femra të bukura të cilat janë të pamoralshme. Kryesisht, ato e kryejnë këtë profesion si mënyrë që ta përkrahin veten, mirëpo ka edhe disa raste kur femrat

bëhen prostituta sepse ato dëshirojnë të fitojnë më shumë të holla, më parë se të merren me diçka tjetër – ato vendosin të bëhen prostituta dhe të fitojnë të holla, më parë se të merren me diçka tjetër. (Prishtinë, Zonë me shumicë shqiptare)

Këto femra janë pa karakter, ato janë të pamoralshme, njëjtë sikurse klientët sepse unë po ashtu e di që kam vepruar gabimisht dhe nuk është dashur t'i vizitoj këto klube të natës. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë e di se viktimat e trafikimit e bëjnë këtë punë për shkak të kënaqësisë dhe për shkak të hollave që i fitojnë. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Sipas mendimit tim, viktimat e trafikimit kanë jetë të vështirë dhe zakonisht vijnë nga vendet e varfra. Ato mashtrohen nga trafikantët; zakonisht vijnë nga Moldavia apo Rusia. Janë të paarsimuar dhe të reja, nga fshati apo qyteti. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Punëtorët e seksit vijnë nga vendet e ndryshme: Moldavia, Bullgaria, Rusia, Shqipëria, por po ashtu ka prostituta nga Kosova. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Viktimat e trafikimit janë persona nga familjet e varfra nga Rusia, Moldavia, Shqipëria, etj. Këto femra kryesisht janë të paarsimuar. Ato janë të reja, po eksperiencë pune, dhe eksperiencë e vetme që ato kanë janë në lokale nate si prostituta. (Prishtinë, Zonë me shumicë shqiptare)

Punëtorët e seksit janë vajza të reja, prej moshës 18 deri 28 vjet. Shpesh ato fillojnë studimet, mirëpo për shkak të pamundësisë të paguajnë për studimet e veta ato kërkojnë punë. Këto vajzat kryesisht vijnë nga Rusia, Bullgaria dhe Bosna. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Informimi lidhur me trafikimin

Siç e kemi cekur më parë, të gjithë respondentët i kanë vizituar prostitutat dhe janë të vetëdijshëm për objektet në komunitetet e tyre ku ofrohen shërbimet seksuale. Të gjithë respondentët konfirmojnë se vendet e tilla ekzistojnë në zonat ku ata jetojnë apo në rrethin e ngushtë. Opinione të ndryshme për vendet e tilla dallojnë. Përderisa disa janë mjaft indiferent për këto vende, të tjerët e kritikojnë ashpër ekzistencën e lokaleve të tilla.

I di shumë vende ku prostitucioni praktikohet. Vende të tilla nuk ka në fshatin tonë por ka mjaft në rajonin tonë. Gjithashtu, unë i njoh shumë njerëz të cilët i vizitojnë këto klube. Unë kam mendim të keq për këta njerëz dhe për këto vende. Këto vende nuk i sjellin asgjë të mirë shoqërisë sonë. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë kam njohuri për vendet ku ka prostitucion. Këto vende janë të njohura si klube të natës apo kafiteri. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore punojnë në këto vende si kameriere dhe pastruese, por ato gjithashtu duhet të ofrojnë shërbime seksuale për klientët që janë të interesuar për një gjë të tillë. Shpeshherë këta i rrahin këto vajza, nëse ato refuzojnë të bëjnë diçka që këta persona dëshirojnë. Si i tilla, unë nuk e

favorizoj një trajtim të tillë johuman ndaj askujt; rrjedhimisht, e dënoj ekzistimin e këtyre vendeve. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Vende të tilla ka sa të duash. Përderisa një mbyllet, tjetra hapet. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë mendoj se vendet e tilla janë klube të natës ku njerëzit e ri shkojnë. Nuk kam ndonjë mendim të veçantë për këto. Në parim, jam kundër aktiviteteve të tilla pasi që në këtë mënyrë ekziston mundësia e infektimit me sëmundje të ndryshme. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Nëse kjo dukuri është legale dhe prostitutat kontrollohen nga mjekët, do të isha për, por pasi që prostitucioni është ilegal dhe ato nuk paguajnë tatime, pronarët e tyre duhet të burgosen. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë kam mendim negativ për vendet e tilla. Personalisht, nuk e njoh ndonjë person i cili i viziton këto vende. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Prania e informatave për trafikim

Responentët kanë mendime të ndryshme sa i përket pranisë së informatave për trafikim. Përderisa disa thonë se informatat e dhëna publikisht për këtë çështje janë të mjaftueshme, të tjerët kanë mendim të kundërt. Njëri nga responentët beson se publiku nuk është i informuar mjaft për këtë çështje dhe thekson se një vëmendje e veçantë duhet t'i jepet edukimit të rinisë për këtë çështje. Responentët kanë marrë informata për trafikim nga burime të ndryshme. Përveç informatave të dhëna në media, trafikimi i qenieve njerëzore diskutohet në mes të shoqërisë (edukim shoqëror).

Ka deri diku informata nëpër media për trafikimin e qenieve njerëzore por këto janë të pamjaftueshme. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë mendoj se nuk ka informata të mjaftueshme për trafikimin e qenieve njerëzore në media. Do të doja që më shumë informacione t'i jepeshin popullatës. I kam parë disa artikuj në gazeta për trafikimin e qenieve njerëzore edhe pse duhet të ketë shumë më shumë se kaq. (Podujeve, Zonë me shumicë shqiptare)

Më shumë vëmendje duhet t'i jepet ngritjes së vetëdijes se ky problem mund të shkaktojë dëm të spektrit shumë më të gjerë se sa një i ri tipik mendon. Për më tepër, të rinjtë, nëse nuk kanë partnere dhe dëshirojnë të marrin shërbime seksuale, ata duhet të informohen se vizita një prostitute nuk është opsion pasi që dëmi që ata janë duke e shkaktuar me atë veprim është afatgjatë dhe i madh. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë mendoj se njerëzit nuk janë mirë të informuar sepse unë vetë nuk kam pranuar informata të mjaftueshme për këtë dukuri. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Në publik, duhet të ketë më shumë informata për trafikimin e qenieve njerëzore. (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Shumica e respondentëve nuk mund të emërtojnë ndonjë organizatë e cila lufton trafikimin. Vetëm një respondent e ka përmendur Organizatën Ndërkombëtare për Migrim. Të tjerët kanë thënë se ka organizata të tilla në komunitetet e tyre, por që nuk kanë arritur ndonjë rezultat. Ata besojnë se autoritetet përgjegjëse dhe policia duhet të merret me këtë problem.

Unë nuk di ndonjë organizatë e cila e lufton trafikimin e qenieve njerëzore, qoftë ndërkombëtare apo vendore. (Podujeve, Zonë me shumicë shqiptare)

Me sa di unë, nuk ka ndonjë organizatë e cila e lufton trafikimin e qenieve njerëzore. Forcat policore janë të vetmet të cilat e luftojnë krimin e tillë. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë e di se Organizata Ndërkombëtare për Migrim i ndihmon viktimave të trafikimit apo prostitutave të kthehen në vendet e tyre. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë nuk jam i vetëdijshëm se ka ndonjë organizatë e cila e lufton dukurinë e tillë. Unë nuk kam dëgjuar për atë. E di se ka shumë organizata të cilat flasim shumë për këtë fenomen por pa rezultate konkrete, pa rezultate praktike. Ata vetëm i bëjnë disa lajmërimi dhe mendoj se me këtë ata nuk mund të bëjnë asgjë për këtë dukuri. Siç e kam cekur më parë, janë institucionet shtetërore ato të cilat janë përgjegjëse për luftimin e trafikimit. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Ka disa OJQ, grupe të ndryshme të njerëzve dhe vullnetarë të cilët punojnë në këtë fushë. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Respondentët pajtohen se më shumë informata për trafikimin e qenieve njerëzore duhet të jepet në media. Rëndësia e programeve televizive - si për shembull video klipet, programet edukative, etj. - për këtë çështje duhet të theksohen. Përmbajtjet e tilla duhet të emitohen në kohën kur shikueshmëria është më e larta. Për më tepër, mediat tjera elektronike dhe të shtypit duhet të raportojnë për trafikimin në njerëz. Një respondent ka thënë se mediat kanë raportuar për këtë problem në mënyrë jo të rregullt dhe se vazhdimësia është parakusht për një fushatë të suksesshme për ngritjen e vetëdijes. Disa respondentë besojnë se informatat në media kanë qenë të pamjaftueshme dhe se më shumë mund të arrihet në dhënien e edukimit specifik për të rinjtë. Me kontakt të drejtpërdrejtë, njerëzit e rinj do të kishin shancë për të pyetur pyetje të ndryshme për trafikimin e qenieve njerëzore dhe aty do t'i merrnin përgjigjet të cilat nuk mund t'i gjejnë në media.

Klipet në TV janë efektive por ato kanë pengesa në dhënien e përgjigjeve në pyetjet të cilat popullata mund t'i ketë. Prandaj, unë mendoj se vizitat e drejtpërdrejta në komunitete të ndryshme do të mundësonin kontakte më të afërta me popullatën dhe në raste të tilla do të ishte e mundur të jepen përgjigje të detajuara dhe të sakta si dhe sqarime shtesë në brengat e tyre. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Mënyra më e mirë për të informuar popullatën për trafikimin e qenieve njerëzore është nëpërmjet televizionit, në kohën kur shikueshmëria është më e larta, kur audiencia është e madhe dhe mundësia që secili ta merr atë informatë është shumë më e lartë se zakonisht. (Podujeve, Zonë me shumicë shqiptare)

Duhet të ketë më shumë programe televizive, programe në radio, artikuj në gazeta, ligjëratat në shkolla ku adoleshentët do të mësonin për trafikimin. Gjithashtu, broshurat i shërbejnë qëllimeve të tilla. Unë do ta informoja policinë dhe deri tani nuk e kam

bërë një gjë të tillë pasi që viktimat që i kam takuar nuk i takojnë popullatës tonë. (Prishtina, Zonë me shumicë shqiptare)

Do të doja që në media të shoh më shumë emisione edukative me materiale për trafikimin e qenieve njerëzore të cilat do të emitoheshin vazhdimisht për një periudhë më të gjatë kohore. Për momentin, mediat emitojnë materiale të tilla vetëm kohë pas kohe. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

Mënyra më e mirë për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore është duke pasur sa më shumë informata për te nëpërmes kanaleve të ndryshme të mediave (TV, radio, gazeta, broshura, ligjërata në shkolla, etj.) (Zubin Potok, Zonë me shumicë serbe)

Përkundër faktit se shumica e respondentëve kanë informata për trafikimin në njerëz vetëm disa prej tyre do të ndanin informatat me autoritete apo policinë. Ata e arsyetojnë këtë me frikën për sigurinë e tyre. Të tjerët theksojnë se ata do të raportnin informatat e tilla menjëherë, dhe në shumicën e rasteve do ta informonin policinë. Disa njerëz duhet se nuk i besojnë autoriteteve apo policisë. Ata besojnë se policia nuk është duke bërë mjaft për ta ndaluar trafikimin e qenieve njerëzore përkundër informatave të mjaftueshme që ata i kanë për praninë dhe përhapjen e kësaj dukurie në Kosovë. Për shkak të kësaj, ata besojnë se raportimi i rasteve specifike për trafikim nuk do të përfundonte me rezultat pozitiv.

Nëse do të kisha ndonjë informatë për trafikim të qenieve njerëzore, unë nuk do të shkoja apo nuk do ta ndaja këtë informacion me ndonjë entitet tjetër. Jam i brengosur për sigurinë time personale sepse do të ndihesha i rrezikuar. (Peja, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë nuk do ta informoja askënd pasi që këta persona janë mafioz dhe ata janë të organizuar në grupe dhe mendoj se aty nuk ka siguri. Këta njerëz janë të rrezikshëm. (Gjilan, Zonë me shumicë shqiptare)

Nuk e di se kujt duhet t'i tregoj për viktimat e trafikimit pasi që çdokush dinë për këtë gjë. Gjithashtu, policia është në njohuri për këto vende. (Ferizaj, Zonë me shumicë shqiptare)

Unë do ta ndaja këtë njohuri nëse do të isha dëshmitar i ndonjë rasti të trafikimit të viktimave njerëzore. Në këtë mënyrë, unë do t'i inkurajoja të tjerët të veprojnë njëjtë, në rast se ata janë dëshmitar të rasteve të ngjashme. (Mitrovica, Zonë me shumicë serbe)

10. Shtojca – Metodologjia

Hulumtimi kuantitativ – Popullata e përgjithshme

Metoda e intervistave

Ballë për ballë, intervista në ekonomi familjare/në shtëpi.

Mostra

Lloji i mostrës

Mostër e rastësishme e stratifikuar sipas rajoneve.

Madhësia e mostrës

500 intervista.


Grupet në shënjestër

Audienca në shënjestër për këtë pjesë të hulumtimit ka zgjedhur rastësisht anëtarët e ekonomive shtëpiake kosovare. Respodentët kanë qenë: 16 vjeçar dhe më të vjetër, rastësisht të zgjedhur sipas teknikës *Ditëlindja e fundit*.

Madhësia e mostrës dhe selektimi i pikave primare të mostrës

Detyrë e rëndësishme në dizajnimin e një sondazhi është marrja e vendimit për madhësinë e përgjithshme të mostrës. Thënë më thjeshtë, madhësia e përgjithshme e mostrës përcaktohet nga dy faktorë: mbështetshmëria e kërkuar për konkluzione statistikore dhe kosto. Figura A2.1 përshkruan lidhshmërinë në mes të madhësisë së mostrës dhe gabimit të mostrës për dhjetë madhësi të ndryshme të mostrës, me nivel të konfidencës prej 95%. Sa më i madh që të jetë mostra, më e vogël do të jetë margjina e gabimit, mirëpo pasi që të kalohet një pikë e veçantë – shembull madhësia e mostrës prej 1,000 respodentëve – përmirësimi është shumë i vogël. Një madhësi e mostrës tejet e vogël, të themi prej 50 respodentëve, ka rreth 14 për qind margjinën e gabimit përderisa mostra prej 1,000 respodentëve ka margjinën e gabimit prej rreth 3 për qind. Lexuesi lehtë mund të verifikoj margjinën e gabimit më pak se $\pm 5\%$ për madhësi të mostrës prej 500 respodentësh në këtë sondazh.

Figura 1: Gabimi i mostrës si funksion i madhësisë së mostrës (niveli i konfidencës 95%)



Si hap i parë i këtij hulumtimi, madhësia e mostrës (numri i respondentëve të intervistuar) është definuar si N=500 respondentë. Kjo mostër pastaj është ndarë në bashkësi të pikave fillestare prej 5 anketash për një pikë fillestare (për madhësi të mostrës prej 500 respondentësh janë dashur 100 pika fillestare). Pikë fillestare është zonë në të cilën anketuesi duhet të kryej një numër të planifikuar të anketave.

Procedurat vijuese janë përdorur për përzgjedhjen e pikave primare fillestare:

1. Për këtë sondazh, territori i Kosovës është ndarë në dy zona të shumicës etnike – zonë me shumicë shqiptare dhe serbe. Këto dy zona me shumicë etnike dallojnë në masë të konsiderueshme në kulturë, gjuhë, zhvillim ekonomik, dhe politika, që në fakt formojnë dy entitete të ndara.
2. Numër i caktuar i pikave fillestare janë alokuar për secilën nga këto dy zona me shumicë etnike plus grupeve të tjera etnike.
3. Secila nga këto zona të shumicës etnike pastaj janë ndarë në numër të caktuar të rajoneve gjeografike.

Përzgjedhja e vendbanimeve dhe pikave fillestare

Brenda secilës komunë, vendbanime të ndryshme janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga lista e vendbanimeve/zonave të banuara. Kjo veçanërisht i përket pjesëve të qytetit në viset urbane, dhe fshatrave individuale në viset rurale. Jo më shumë se 5 ekonomi familjare janë anketuar për një

vendbanim. Për secilën komunë Prism ka rezervuar një numër të rrugëve dhe fshatrave në rast se ka ekzistuar nevoja. Ndonjë herë ndodh që ndonjë fshat i përzgjedhur të jetë i braktisur apo/dhe plotësisht i shkatërruar. Në raste të tilla, fshati i parë nga lista rezervë zëvendëson këtë vendbanim. Në raste ekstreme, ku lista e fshatrave zbrazet për shkak të braktisjes apo shkatërrimit, anketuesit janë të lejuar të përzgjedhin fshatin e parë fqinje ku është e mundur të kryhet sondazhi.

Rrugët e përzgjedhura janë alokuar rastësisht nga një numër në mes 1 dhe 300, që përfaqëson adresën e pikës fillestare. Nëse është numër tre-shifror, dhe rruga e përzgjedhur nuk ka numër të tillë, atëherë anketuesi injoron shifrën e parë dhe kalon tek adresa e numrit të mbetur dy-shifror (ngjashëm edhe për numrat një-shifror nëse nuk ka adresë me numër dy-shifror).

Në rast se në rrugën e përzgjedhur nuk janë të shënuara ndërtesat/shtëpitë, anketuesi njehson hyrjet e ndërtesave/shtëpive në një anë të rrugës dhe hyn në shtëpinë e cila korrespondon me numrin rastësisht të përzgjedhur. E njëjta procedurë aplikohet edhe në fshat, përveç një dallimi që në këto vendbanime zakonisht janë të ndara në katër sektorë dhe së paku një anketë kryhet në një ekonomi familjare për secilin sektor. Vija të imagjinuara që ndajnë fshatin vertikalisht dhe horizontalisht në katër sektor përafërsisht të njëjtë definojnë sektorët.

Përzgjedhja e Ekonomive Shtëpiake

Teknika e *Ecjes së Rastësishme* është përdorur për të përzgjedhur secilën ekonomi familjare. Anketuesit i është dhënë adresa specifike për pikë fillestare për secilën pikë fillestare sekondare. Kjo ka qenë ndonjë numër/adresë specifike. Në vise rurale kjo ka qenë ndonjë ndërtesë apo pikë referuese, siç është ndërtesa e bashkësisë lokale, zyra e Postës, apo shkolla lokale. Vendbanime me madhësi të ndryshme kërkojnë udhëzime të ndryshme për përzgjedhjen e pikës fillestare. Në disa raste koordinatorët rajonal përcaktojnë pikën fillestare pas vizitës që ja bëjnë vendbanimit.

Anketuesit janë udhëzuar që të drejtohen me fytyrë drejt pikës fillestare. Pastaj të ecin në të djathtë duke përzgjedhur shtëpinë e dytë si ekonominë familjare të parë për anketim. Nëse struktura e dytë është banesë (disa kateshe), ai/ajo do të përzgjedh njësinë e dytë banesore si ndërtesë ku do të fillon anketimit.

Pas anketimit, ata kalojnë në banesën apo shtëpinë e radhës dhe përzgjedhin njësinë e katër banesore për anketimin e dytë. Pastaj vazhdojnë me këtë model derisa të kompletoj kuotën për atë vendbanim. Në fshat, anketuesi përzgjedh së paku një ekonomi familjare për secilin nga katër sektorët siç është cekur më lartë. Në njërin sektor ata përzgjedhin dy ekonomi familjare (të dytin sa më afër qendrës së fshatit) që të përfundoj anketën e pestë për atë pikë fillestare.

Përzgjedhja e responentëve

Anëtarët e ekonomisë familjare që duhet anketuar janë përzgjedhur me kriterin e *Ditëlindjes së Fundit* – i.e. anëtari i ekonomisë familjare 16 vjeçar apo më të vjetër i cili i fundit e ka festuar ditëlindjen. Procedura e mëposhtme është aplikuar:

Në derë, anketuesi ka kërkuar të bisedoj me anëtarin e ekonomisë familjare ditëlindja e të cilit është më e afërt me datën kur është kryer anketimit. Nëse, pas përzgjedhjes së responentit, del se responenti nuk është në shtëpi, anketuesi kthehet edhe dy herë në atë adresë që të takoj responentin. Në rast se responenti nuk është në shtëpi edhe pas vizitës së tretë, koordinatori për punën në terren i ofron udhëzime anketuesit si të zëvendësoj adresën që të përcaktoj responent tjetër. Adresat rezervë nuk ofrohen përdërisa procedurat e vizitës së serishme nuk shteren. Përrjashtim për këtë janë lokacionet rurale tek të cilat vështirë arrihet.

Në asnjë mënyrë anketuesi nuk mund të zëvendësoj ndonjë anëtarë tjetër të ekonomisë familjare si respondent. Një herë që një anëtarë i familjes përzgjedhjet për të qenë respondent, anketa kryet vetëm me atë anëtarë të ekonomisë familjare. Kjo metodë siguron se përzgjedhja e rastit e respondentëve bazohet në kriterin e *Ditëlindjes së Fundit*.

Rekrutimi dhe organizimi i punës në terren

Numri i anketuesve të angazhuar në këtë hulumtim ka qenë 30: 25 shqiptar të Kosovës dhe pesë serb të Kosovës. Secili ka qenë i angazhuar në zonën shumicë përkatëse. Asnjë anketuesi nuk ka pranuar më shumë se 20 pyetësor për të kompletuar.

Numër i nevojshëm i koordinatorëve janë angazhuar me princip të një koordinatori për jo më shumë se pesë anketues. Andaj, janë angazhuar pesë koordinator për zonën me shumicë shqiptare dhe një për zonën me shumicë serbe (për shkak të menaxhimit më të lehtë të enklavave). Menaxheri i Punës në terren për pjesën shqiptare të mostrës është i vendosur në zyrën e Prism Research në Prishtinë. Menaxheri i Punës në terren për pjesën serbe të mostrës është i vendosur në Zubin Potok – pjesa veriore e Mitrovicës (për arsye të sigurisë dhe qasjes më të lehtë).

Numri i kontrollorëve është përcaktuar në mënyrë të ngjashme. Një kontrollor është përcaktuar për jo më shumë se 5 anketues – andaj, gjashtë kontrollor janë angazhuar.

Trajnimi

Të gjithë koordinatorët rajonal dhe anketuesit kanë marrë pjesë në një trajnim një-ditor qoftë në Prishtinë apo Zubin Potok.

Në trajnim të koordinatorëve dhe anketuesve, temat në vijim janë rishikuar:

- § Sqarim për qëllimin e këtij projekti
- § Rishikim seksion-për-seksion i pyetësorit (analiza Pyetje për Pyetje)
- § Prova të ndryshme të anketimit ('role play')
- § Diskutim i hollësishëm i nxitjes së drejtpërdrejtë dhe indirekte

Anketuesit kanë administruar anketë provuese në treshe, ku janë mbikëqyrur nga menaxheri i punës në terren dhe koordinatori.

Mbikëqyrja

Secili anketues është dashur që së paku të kryej një anketë me apo pa mbikëqyrjen e koordinatorit. Gjatë punës në terren koordinatorët kanë kontrolluar secilin pyetësor të plotësuar të minimizoj numrin e pyetësorëve të administruar gabimisht apo për gabimet e anketuesve të pavërejtura.

Kontrolli i kualitetit të anketuesve

Puna e anketuesve është kontrolluar në mënyrat vijuese:

- § *Regjistrimi i të gjitha kontakteve në terren dhe anketave të përfunduara (100 %)* është krijuar që të sigurohet se anketuesi ka përcjell rregullat e mostrës
- § *Kontrolli logjik i pyetësorëve (100 %)* është zhvilluar të tregon se pyetësorët janë plotësuar saktë dhe të gjitha përgjigjet janë shënuar në mënyrë të drejtë

- § *Kontrrolli përmes telefonit (30%)* nëpërmjet thirrjeve telefonike respondentëve, të verifikohet nëse anketimi është kryer në adresat e sakta, se përzgjedhja e respondentit ka ndodhur në mënyrë të saktë, dhe të pyetet për sjelljen e anketuesit dhe administrimin e pyetësorit
- § *Kontrrolli në terren (30 %)*, nëpërmjet vizitave në terren, ku nuk ka linja telefonike apo kur respondentët nuk ofrojnë numër të telefonit, të monitorohen adresat e marra nga anketuesit. Këto Prism ka verifikuar se anketimet janë kryer në adresat e sakta, se janë përcjell rregullat gjatë përzgjedhjes së respondentit, dhe të pyetet për sjelljen e anketuesve dhe administrimin e pyetësorit
- § *Kontrrolli kompjuterik i të dhënave të mbledhura (100%)*, ku Prism ka matur papajtueshmërinë që mund të ketë ndodhur në mes të anketuesve të ndryshëm.
- § Përfaqësuesit nga KOPF po ashtu kanë monitoruar mbledhjen e të dhënave. Punonjësit e KOPF kanë shoqëruar anketuesit e Prism dhe kanë monitoruar aktivitetet e tyre.

Futja e të dhënave dhe pastrimi

Prism ka përdorur aplikacion për futjen e të dhënave ku një formë është krijuar e cila korrespondon me pyetësorin e zhvilluar për këtë hulumtim. Operatorët e trajnuar kane futur të dhënat në kompjuter, të cilat pastaj janë pastruar, që do të thotë se gabimet të cilat kanë mundur të ndodhin gjatë futjes së të dhënave janë eliminuar duke përdorur aplikacione kompjuterike. Kontrrolli dhe përgatitja e të dhënave për procesim të mëtutjeshëm është kryer me aplikacionin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences).

Pyetësori

Prism Research, në konsultim të ngushtë me klientin dhe bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, ka zhvilluar pyetësorin. Çfarëdo ndryshimi në pyetësor është bërë me aprovimin e klientit. Prism Research ka përfunduar dokumentin duke e përkthyer në shqip dhe serbisht. Pyetësori është shtypur në formë broshure të formatit A4.

Sondazhi – Grupi më i rrezikuar

Shumica e dizajnit të hulumtimit të përdorur për audiencën e parë në shënjestër është përdorur edhe me të dytën. Mirëpo, dizajni i rastësishëm i stratifikuar për këtë instancë të mostrës i përket kuotave prej 300 respondentëve të përcaktuar për këtë audiencë në shënjestër.

Audienca e dytë në shënjestër përbëhet prej grupit më të rrezikuar, në fakt të vajzave prej moshës 14 deri 8⁸ vjet, që vijnë nga familjet e varfra me status më të ulët social dhe prapavijë arsimore. Për këtë arsye, kuotat janë përcaktuar duke u mbështetur në kriteret vijuese:

- § Lloji i vendbanimit
- § Moshë,
- § Arsimimi,
- § Të hyrat e familjes,
- § Niveli më i lartë i arsimimit i fituar nga ndonjë anëtarë i familjes.

Përdorimi i kriterëve të cekura më lartë ka siguruar përzgjedhjen e respondentëve të cilat duket se i përgjigjen profilit të viktimave vendore të trafikimit. Kuotat e mostrës janë bazuar në informata e mbledhura prej anketuesve me përfaqësues të organizatave që ndihmojnë viktimat e trafikimit – të “shtëpive të sigurta” të cilat ofrojnë strehim viktimave të trafikimit andaj edhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ato. Organizata të tilla punojnë me numër të konsiderueshëm të viktimave të trafikimit dhe janë përdorur njohuritë e tyre për të krijuar profilin e viktimës vendore të trafikimit.

Puna në terren për dy audiencat e para në shënjestër ka qenë e organizuar në mënyrë simultane, andaj kurdo që anketuesi ka vizituar një familje apo respondent i cili ka plotësuar kriteret e nevojshme për audiencën e dytë në shënjestër, ai/ajo ka mundur të kryej anketën me anëtarin që i përket audiencës së dytë në shënjestër. Nëse e gjithë kuota nuk është përfunduar përderisa anketuesi ka kryer pikën fillestare, *Metoda e Topit të Dëborës* është përdorur për të identifikuar respondentin nga mostra e mbetur për audiencën e dytë në shënjestër. *Metoda e Topit të Dëborës* është metodë jo e rastësishme, që përdoret kurdo që nevojitet të arrihet tek ndonjë karakteristikë specifike e mostrën, në mënyrë që mostra të kompletohet në rajonin e caktuar. Anketuesi identifikon respondentin i cili i plotëson karakteristikat e nevojshme dhe kërkon nga respondentin që të identifikoj një person tjetër që i përgjigjet përshkrimit.

Mostra prej 300 respondentësh është kompletuar, dhe margjina e gabimit këtu ka siguruar baraspeshë në mes të kostos dhe efikasitetit (margjina maksimale e gabimit, siç është e përshkruar më herët në grafikun, për mostër 300 është +/- 5.5%).

Si shtesë të hulumtimit kuantitativ, Prism po ashtu ka kryer dhjetë intervista me viktimat të trafikimit. Shumica po jo të gjitha këto viktimat kanë qenë vajza të reja të kontaktuar përmes strehimoreve. Punonjësit e këtyre vendeve janë informuar me përshkrim të detajshëm të intervistave të propozuara, me përshkrim të metodologjisë dhe procedurave të aplikuara për këtë projekt hulumtues. Prism po ashtu ka konsultuar me Qendrat për Punë Sociale lidhur me këto intervista. Punonjësit e strehimoreve kanë kontaktuar viktimat e mëhershme (të shpëtuar/mbijetuara), duke kërkuar nga ato nëse janë të gatshme të intervistohen lidhur me përjetimet e tyre. Për shkak të ndjeshmërisë së temës së hulumtimit, dhe për shkak të ruajtjes së anonimitetit dhe konfidencialitetit, punonjësit e strehimoreve kanë kryer intervistat. Prism ka besuar se viktimat e mbijetuara do të jenë më të hapura të diskutojnë përjetimet personale me një person

⁸ Pajtimi i prindërve është siguruar për të anketuar këto vajza.

të njohur për ato, më parë se me ndonjë intervistues të panjohur. Punonjësit e strehimoreve të përzgjedhura të kryejnë intervistat janë udhëzuar për pyetjet, dhe me metodologjinë dhe procedurat për administrim të intervistave. Intervistat nuk janë incizuar, kështu që marrja aktive e shënimeve është inkurajuar dhe raporti për secilën intervistë është prodhuar menjëherë pas bisedës.

Hulumtimi kualitativ – Intervistat me klient të punëtorët e seksit komercial

Hyrje

Hulumtuesit social në përgjithësi pajtohen se mënyra më efikase e dizajnit hulumtues është ajo që kombinon qasje të ndryshme metodologjike për të kompletuar njëra tjetrën – kryesisht metodat kualitative dhe kuantitative. Përmes intervistave ne fitojmë depërtim në prapavijën komplekse të opinioneve dhe qëndrimeve, arsyeve, motiveve të grupeve në shënjestër që lidhet me çështjen e cila hulumtohet. Për më tepër, intervistat janë mënyrë efikase të testohet ndonjë nga hipotezat apo supozimet fillestare.

Metoda

Intervista.

Rekrutimi

Prism Research ka rrjet të gjerë që përbëhet prej anketuesve, kontrollorëve, koordinatorëve dhe mbikëqyrësve në të gjitha komunat e Kosovës. Të gjithë anketuesit kanë kaluar nëpër trajnim rigoroz mbi metodologjinë hulumtuese dhe kanë marrë pjesë në së paku 5 projekte hulumtuese në Kosovë gjatë 12 muajve të fundit.

Grupet në shënjestër dhe lokacionet

Grupet kryesore në shënjestër për këto intervista janë:

- Ø Meshkujt shqiptar të moshave të ndryshme – klientë të punëtorëve të seksit komercial, dhe
- Ø Meshkuj serb të moshave të ndryshme – klientë të punëtorëve të seksit komercial

Prism ka rekrutuar klient meshkuj, gjysma nga viset urbane dhe gjysma nga viset rurale. Intervistuesit/rekrutuesit kanë përdorur metodën e *Topit të Borës* të përzgjedhin respondentët potencial – nga grupi në shënjestër.

Në përzgjedhjen përfundimtare të pjesëmarrësve, vëmendje të veçantë i është dhënë që:

1. Ai person nuk është në lidhje farefisore me intervistuesin apo punonjësit e Prism Research dhe që pjesëmarrësit të mos kenë lidhje farefisnore në mes veti;
2. Pjesëmarrësit të mos jenë të punësuar apo përfshirë në çfarëdo mënyre në media, organizata marketingu, apo organizata të hulumtimit të opinionit publik;
3. Të mos kenë marrë pjesë në çfarëdo hulumtimi të opinionit publik apo intervistë në 12 muajt e kaluar.

Moderimi

Për intervistimin e klientëve, Prism ka përdorur punonjësit permanent në Kosovë (ata të cilët rregullisht i angazhon në baza të projekteve), të cilët janë psikolog apo sociolog. Puna e tyre është koordinuar dhe mbikëqyrur nga Menaxheri i Projekteve nga departamenti i hulumtimeve kualitative në Prism.

Udhëzuesi për intervistim

Prism Research ka zhvilluar Udhëzuesin për intervistim duke përcjell çështjet kyçe të identifikuara nga klientët (CRS dhe KOPF) dhe Prism Research.

Organizimi

Pjesëmarrësit në intervista kanë pranuar shpërblim simbolik për pjesëmarrjen e tyre. Prism përdor këtë formë të rris gatishmërinë e responentëve të marrin pjesë në hulumtim.

Intervistat nuk janë incizuar për shkak të ndjeshmërisë së çështjes që është diskutuar. Për kompletimin e intervistave, hulumtuesit kanë mbledhur të dhënat e tyre në raporte. Këto raporte kanë përcjell udhëzuesin për intervista të tilla dhe diskutimi narrativ i klientit është bazuar në këto vija.

Kërkim Studimor mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore



PISG
Office of the Prime Minister Kosovo
OFFICE FOR GOOD GOVERNANCE

Office of the Prime Minister
Office for Good Governance
Mother Theresa St.
10000 Prishtinë, Kosovo
Tel/Fax: 200 104 855
www.ko-gov.net/pisg



USAID
NSA POPULLI AMERIKAN
DD AMERIKËS NË KOSOVO

Arbata (Dragodan)
Ismail Qemal St., No.1
Prishtina, Kosovo, 10130
Telephone: ++ 381 (0)38 243 673
Fax: ++ 381 (0)38 249 493
www.usaid.gov/mi/salonsk/ko/ovo



CRS Kosovo/1000 Prishtinë
Rr. Dukagjini, St. No. 39/A (Atash II)
Tel/Fax: +381 38 249 602, 249 744
www.catholicrelief.org

KOPF

Kosovo Population Foundation

Esrem Çabë Bil. 4, Nr. 12
10000 Prishtina-Kosovo
Tel: +381 / 38 - 247 930
Fax: +381 / 38 - 247 935
www.kopfund.org



PRISM RESEARCH
marketing + media + social research

Prism Research
Obala Kulina Bana 15/1
71000 Sarajevo
Bosnia and Herzegovina
Tel: +387 33 251 330
Fax: +387 33 251 238
www.prismresearch.ba

Cilat janë njohuritë, vlerat, dhe perceptimet lidhur me trafikimin?
Kush janë klientët e punëtorëve seksual?
Cili është niveli i vetëdijësimit mbi trafikimin dhe pasojat
e tij tek grupet e marginalizuara (vajzat e reja)?
Kush janë viktimat?